



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 549/6 Prot.

Tiranë, më 16.02 2023

V E N D I M

Nr. 27 dt. 16.02 2023

“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË  
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË UNIVERSITETIN E  
SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 33 paragrafi 3, 38, 77 paragrafi 4 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4, 19,20, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, si dhe mbështetur në shkresën Komisionit të Përhershëm të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” të FSHL me nr. 2002/3 Prot., datë 09.02.2023, Senati Akademik në datën 16.02.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores së re për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës (bashkëlidhur vendimit).
2. Rregullorja e Komisioneve të Përhershme të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” në UST, e miratuar me Vendimin Nr. 40, Datë 21.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Komisioneve të Përhershme për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe Manualit për Procedurat për Aplikimin dhe Pranimin në Ciklin e Tretë të Studimeve të Doktoratës në UST”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko- Shkencore për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**RREGULLORE**

**PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË**  
**CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”**  
**NË**  
**UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

**Miraturar në mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës**  
**me Vendimin Nr. \_\_\_\_\_, datë ...../...../2023**

**Tiranë, 2023**

# **KREU I TË PËRGJITHSHME**

## **Neni 1**

### **Objekti dhe qëllimi i rregullores**

Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave të përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të programeve të studimit të doktoratës në njësitë bazë/kryesore të Universitetit të Sporteve, Tiranë, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtaritë e lidhura me këto programe studimi.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Kjo Rregullore bazohet në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (këtu e në vazhdim Ligji nr.80/2015) si dhe akteve nënligjore, dalë në bazë dhe për zbatim të tij sipas **Shtojcës 1** të kësaj Rregulloreje.

## **Neni 3**

### **Objektivat e programeve të studimit të Doktoratës**

Programet e studimit të doktoratës, janë studime të ciklit të tretë të formimit universitar në zbatim të pikës 1 të nenit 77 të ligjit nr. 80/2015, në përfundim të të cilave lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”.

Objektivat e këtyre programeve të studimit janë:

1. Programet e studimit të doktoratës në UST synojnë nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat/nënfushat kërkimore që studjohen në UST, orientimin drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe integritimit të njohurive e rezultateve të kërkimit dhe sjelljen e risive në kërkimin e mendimin shkencor.
2. Programet e studimit të doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor të pavarur, si bazë për hulumtimin, përfundimin e rezultateve e risive në fushë, që lidhen me projektet kërkimore të njësisë bazë/kryesore e që shërbejnë si bazë për përgatitjen e disertacionit të doktoratës, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

## **Neni 4**

### **Stuktura që ofron programet e doktoratures ne USTdhe kohëzgjatja**

1. Programet e studimit të doktoratës mund të ofrohen nga njësitë bazë, grupime të njësisive bazë ose në bashkëpunim me struktura kërkimore vendase ose të huaja bazuar në marrëveshjet përkatëse.

2. Programet e studimit të doktoratës, ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato zhvillohen në kuadër të projekteve kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit në njësitë bazë, kryesore dhe atyre ndërfaqultetore të UST-së.
3. Këto studime zgjasin 3 – 5 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

## **KREU II**

### **ORGANET DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR DREJTIMIN DHE MBARËVAJTJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS**

#### **Neni 4**

##### **Struktura**

Organet dhe autoritetet përgjegjëse për drejtimin dhe mbarëvatjen e programeve të studimit të ciklit të tretë të Doktoratës në Universitetin e Sporteve të Tiranës janë:

1. Komisioni i Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
2. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”
3. Përgjegjësi i Programit të studimit të Doktoratës
4. Drejtuesi i Njesisë Kryesore/Departamentit përgjegjës për programin/programet e studimit të Doktoratës
5. Koordinator i programit të studimit të Doktoratës
6. Udhëheqësi shkencor i kandidatit

#### **Neni 5**

##### **Drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit të Doktoratës**

Janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të Doktoratës:

1. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” i cili është përgjegjës për monitorimin e procesit, vlerësimin dhe procedurën e mbrojtjes së dizertacionit dhe marrjen e vendimit përfundimtar për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
2. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” e cila vlerëson disertacionin e kandidatit për gradën shkencore “Doktor” dhe mbrojtjen e tij.
3. Njësitë bazë, në njësitë kryesore të UST-së. Kur programi i studimit ofrohet nga më shumë se një njësi bazë, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit të doktoratës, përcaktohen në bashkëpunim të njësive bazë me njëra-tjetrën sipas marrëveshjeve të hartuara prej tyre. Në rast të programeve që përfshijnë më shumë se një njësi bazë, njëra prej njësive bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi midis tyre. Njësitë

bazë mund të mbështeten edhe nga qendrat kërkimore-shkencore për realizimin e programit të doktoratës.

4. Përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore, i cili drejton programin në bashkëpunim me Koordinatorin/ët përkatës të programit/eve të studimit të doktoratës në njësitë bazë.

## **Neni 6**

### **Komisioni i Përhershëm për Dhenien e Gradës Shkencore “Doktor i Shkencave”**

1. Komisioni për dhenien e Gradës Shkencore “Doktor” është Komision i Përhershëm që ngrihet në nivel të njërive kryesore ose në nivel të IAL-se. Komisioni në nivel njësie kryesore ka në përbërje 5 (pesë) antarë, ndërsa ai në nivel institucional jo më shumë se 9 (nëntë) antarë.
2. Antarët e Komisionit zgjidhen me vetëkandidim nga rradhët e Asamblesë së personelit akademik. Anëtarët duhet të kenë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe të kenë jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë pune me kohë të plotë si personel akademik
3. Antarësia në Komisionin e Përhershëm të dhenies së gradës shkencore “Doktor” është i papajtueshëm me funksionet e Drejtuesit të Departamentit Përgjegjës për programin/programet e Studimit të Doktoratës, të Përgjegjësit të Programit të Doktoratës dhe të Koordinatorit/Koordinatorëve të Programit të Doktoratës.
4. Komisioni për Dhenien e gradës shkencore “Doktor” është përgjegjës për monitorimin e procesit dhe dhenies së gradës shkencore “Doktor”.
5. Komisioni monitoron procesin e pranimeve dhe ecurinë e kandidatëve të regjistruar në programin e studimit, por pa ndërhyrë në përgjegjësitë e njësisë bazë dhe kryesore.
6. Komisioni shqyrton ankimime dhe/ose parregullsi të procesit që evidentohen dhe/ose nuk gjejnë zgjidhje nga njësia bazë/kryesore përgjegjëse për programin e studimit.
7. Komisioni mund të ndërhyjë në procedura të procesit (si pranime, vlerësim në fazë të caktuar, përpara mbrojtjes) apo çështje të tjera si pezullimi, anulimi, ndryshimi i temës së kërkimit, udhëheqësit shkencor dhe për të garantuar përmbushjen e kriterëve e procedurave të kërkuara duke garantuar përputhshmërinë me kuadrin ligjor e rregullativ si dhe integritetin e procesit.
8. Komisioni mund të dërgojë përfaqësuesit e tij në takimet që zhvillohen me kandidatët, në referimet e kandidatëve gjatë ecurisë së studimeve dhe përpara mbrojtjes së dizertacionit.
9. Komisioni verifikon dosjen e Kandidatit dhe vlerëson përputhshmërinë me kriteret përpara mbrojtjes së dizertacionit, pas procesit të kryer në njësinë bazë.
10. Komisioni përcakton dhe zgjedh Jurinë për mbrojtjen e dizertacionit kur vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe në këtë rregullore.
11. Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës Shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të Jurisë.
12. Aspekte të tjera të veprimtarisë së të Komisionit të Përhershëm për Dhenien e Gradës Shkencore “Doktor”, përcaktohen në këtë rregullore dhe Rregulloren e funksionimit të tij.

## Neni 7

### Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”

4. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” përzgjidhet nga Komisioni i Përhershëm i dhenies së gradës shkencore “Doktor” të njësisë kryesore sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë rregullore.
5. Administron procesin e mbrojtjes së dizertacionit të kandidatit sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë rregullore.
6. Bën vlerësimin e kandidatit në përfundim të procesit të mbrojtjes
7. Harton aportin përfundimtar të vlerësimit të kandidatit dhe ja përcjell atë Komisionit të Përhershëm të dhenies së gradës shkencore “Doktor” për vendimmarrje.
8. Procedura që ndiqet për procesin e mbrojtjes parashikohet në vijim në këtë rregullore.

## Neni 8

### Përgjegjësi i Programeve të Studimeve të Doktoratës

Programet e doktoratës në nivel të njësisë kryesore drejtohen nga përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës, që si rregull është Zëvendësdekani i cili duhet ti përkasë kategorisë “Profesor”. Në rast se ky kriter nuk përmbushet, këtë rol e luan drejtuesi i njësisë kryesore ose ky i fundit ngarkon një anëtar/e të personelit akademik të njësisë bazë/kryesore i cili i përket kategorisë Profesor.

Përgjegjësi i programit/eve të studimit të Doktoratës ka këto përgjegjësi:

1. Të mbikqyrë dhe të sigurojë që njësitë bazë respektojnë, në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre në lidhje me programet e studimit të doktoratës, kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, në këtë rregullore, në drejtim të:
  - a) respektimit të afateve dhe të kriterëve për shpalljen e hapjes së programit të doktoratës;
  - b) respektimit të rregullave në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve fitues;
  - c) respektimit të kriterëve në lidhje me udhëheqësit shkencorë, përfshirë, por jo vetëm, kriteret në lidhje me titullin akademik, që duhet të ketë udhëheqësi (“Profesor” ose “Profesor i asociuar”), numrin maksimal të doktorantëve që mund të udhëheqë, ekspertizën në fushën specifike të kërkimit si edhe mundësitë reale në ofrimin e një udhëheqjeje cilësore për kandidatët;
  - d) respektimit të procedurave të udhëheqjes dhe shqyrtimit të ecurisë së kërkimit shkencor.
2. Të mbikëqyrë dhe të sigurojë që studentët e doktoratës të informohen për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime dhe rregullore, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”.
3. Përveç detyrave të parashikuara më lart, njësitë bazë mund të parashikojnë në rregulloret e tyre edhe detyra të tjera shtesë që garantojnë mirëfunksionimin programit të studimit.

## **Neni 9**

### **Përgjegjësitë e Njesisë bazë**

1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.
2. Njësia bazë përcakton dhe propozon fushat/nënfushat e kërkimit shkencor, ku do të zhvillohen projektet e doktoratës, të cilat më pas miratohen sipas parashikimeve në vijim në këtë rregullore.
3. Njësia bazë përcakton kuotat dhe kriteret për pranimin e studentëve doktorantë, shqyrton dosjet e aplikantëve dhe miraton listën e kandidatëve fitues në programin e saj të doktoratës.
4. Njësia bazë miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës.
5. Njësia bazë ka përgjegjësi t'u sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore-shkencore pranë institucioneve publike dhe private.
6. Njësia bazë ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale dhe ato të antiplagjiaturës nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.
7. Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.
8. Njësia bazë ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
9. Për çështje të tjera, njësia bazë i drejtohet për vendimmarrje autoriteteve/organeve të tjera sipas parashikimeve në vijim në këtë rregullore.

## **Neni 10**

### **Përgjegjësitë e koordinorit shkencor të programit të studimit**

Programi i studimit të Doktoratës, në nivel të njesisë bazë ndiqet e koordinohet nga koordinatori i programit të studimit të Doktoratës, që zgjidhet ndërmjet antarëve me titull akademik të kategorisë “Profesor”. Koordinatorin ka këto përgjegjësi:

1. Të mbajë dokumentacionin vjetor të listave të kandidatëve, temave kërkimore në studim, progresin e kandidatëve dhe raportet vjetore të ecurisë së tyre.
2. Të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqës shkencorë sipas rregullave për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës.
3. Të interesohet për t'u siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme.
4. Të garantojë se janë respektuar politikat e udhëheqjes.
5. Të garantojë se për zhvillimin e doktoratës zbatohen standardet e kërkimeve shkencore.

6. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, i propozon njësisë bazë ndryshimet e nevojshme.
7. Të garantojë se procedura e mbikqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit është e rregullt.
8. T'i njohë studentët me të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.
9. Koordinatori ndjek realizimin e pagesave periodike për udhëheqësit shkencorë.
10. Koordinatori informon Komisionin e Përhershëm të dhenies së gradës shkencore “Doktor” mbi ecurinë e programit të studimit, raportet vjetore dhe veprimtaritë e njësisë bazë/kryesore gjatë pranimeve, ecurisë dhe çështje të tjera të parashikuara në vijim në këtë rregullore.

## **Neni 11**

### **Udhëheqësi shkencor**

1. Udhëheqësit shkencorë të kandidatëve që ndjekin studimet në programet e ciklit të tretë “Doktoratë” i përkasin kategorisë “Profesor”.
2. Udhëheqësit që mbajnë titullin akademik “Profesor” kanë të drejtë të udhëheqin jo me shume se 3 kandidatë njëkohësisht, në të gjitha IAL-të ku ata janë të angazhuar.
3. Udhëheqësit shkencorë që mbajnë titullin “Profesor i Asociua” kanë të drejtë të udhëheqin jo më shume se 2 kandidatë njëkohësisht, në të gjitha IAL-të ku ata janë të angazhuar; për këtë kategori kanë përparësi ata udhëheqës që mbajnë këtë titull prej të paktën 2 (dy) vite deri në momentin e miratimit të udhëheqjes shkencore.ër të paktën dy vjet .
4. Për programet e përbashkëta ose ndërdisiplinore të Doktoratës, caktohen dy udhëheqës për drejtimin e kandidatëve, një nga secila njësi bashkëpunuese.
5. Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor janë:
  - a. Të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor gjatë udhëheqjes së doktoratës.
  - b. Të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e dizertacionit brenda kohës së parashikuar në aktet ligjore.
  - c. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndër të tjera dhe orientim në lidhje me:
    - i. Formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit.
    - ii. Rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit.
    - iii. Konsulencë të vazhdueshme për realizimin e kërkimit, publikimeve dhe përmbajtjen e dizertacionit.
  - d. Udhëheqësi duhet të mbajë komunikime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit shkencor.



- e. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht (takime të rregullta) duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është në standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- f. Të nxisë dhe mbështesë studentin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj shkencore dhe prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, kur tematika e tyre është në funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe të sigurojë që ato janë në përmbushje të kriterëve të përcaktuara.
- g. Udhëheqësi ka përgjegjësi të informojë, udhëzojë dhe ndërgjegjësojë studentin për rrezikun dhe shmangjen e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
- h. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.
- i. Të paraqesë shqetësime apo parregullsi mbi ecurinë e kandidatit, mosplotësimin e detyrimeve dhe të propozojë masat sipas natyrës së tyre.
- j. Në rastet e bashkëudhëheqjes, udhëheqësi duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë e tyre dhe të mbajnë kontakte të rregullta.

### **KREU III**

## **HAPJA, ORGANIZIMI DHE PRANIMI NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS**

#### **Neni 12**

#### **Hapja e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”**

1. Njësitë bazë/njësitë kryesore të UST-së, mund të paraqesin propozime për hapjen e programeve të studimit të doktoratës, në rast se plotësojnë kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë por jo vetëm:
  - a) Kanë personel akademik të kategorisë profesor (me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”) sipas standardeve të kërkuara në fuqi për këto njësi.
  - b) Kanë numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit në përputhje me kuotat e propozuara.
  - c) Ka struktura të posaçme operative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara nga programi i studimit të doktoratës (laboratorë, biblioteka, dhe infrastrukturën e nevojshme, etj).
  - d) Ka burime financiare mbështetëse.
2. Njësia bazë nëpërmjet njësisë kryesore, i paraqet Senatit të UST-së propozimin për hapjen e programit të ri të studimit të doktoratës ose për riorganizimin e një programi ekzistues, propozim i cili formulohet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Propozimi duhet të përmbajë:
  - a) Fushën/nënfushën e kërkimit shkencor dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës;
  - b) Të dhëna mbi organizimin e programit;
  - c) Të dhëna mbi programin zhvillimor të studimeve të doktoratës;
  - d) Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;
  - e) Fondet financiare për realizimin e procesit të studimit, përfshirë edhe mundësinë e vetëfinancimit ose të granteve për projekte kërkimore;
  - f) Parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës, i cili përcaktohet në përputhje me kapacitetet e njësisë bazë;
  - g) Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat përcaktohen nga njësia bazë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
  - h) Personelin akademik, që do të realizojë udhëheqjen e doktorantëve, si edhe nëse në personelin e angazhuar do të përfshihet personel akademik i ftuar, i cili duhet të miratohet paraprakisht nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse;
  - i) Të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës, që drejtojnë administrativisht programin e studimit të doktoratës, kur ato janë ndërdisiplinare;
  - j) Të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave në formime pasuniversitare, nëse kanë pasur.
4. Studimet e doktoratës propozohen dhe organizohen në kuadër të një projekti kërkimor-shkencor e zhvillimor dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësisë bazë, njësive kryesore dhe UST-së. Këto njësi mund të aplikojnë për financim pranë AKKSHI-it ose pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Në rastet e kandidatëve të cilët janë personel akademik me kohë të plotë, studimet e doktoratës mund të mbështeten nga burimet e brendshme të UST-së. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, kandidati mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo dhe të vetëfinancohet.
5. Pas miratimit nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i UST-së, aplikimi për hapjen/riorganizimin e programit të studimit të doktoratës, i përcillet Ministrisë përgjegjëse për arsimin për vijimin e procedurave në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
6. Programet e studimit të doktoratës konsiderohen të miratuara zyrtarisht pas hyrjes në fuqi të Urdhërit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
7. Çdo njësi kryesore ka detyrimin të bëjë publike fushat/nënfushat e kërkimit të programeve të Doktoratës dhe kriteret e përcaktuara nga njësitë bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron.
8. Fushat e studimeve të Doktoratës përcaktohen nga njësitë bazë dhe i përcillen përmes Njësisë Kryesore, Komisionit të dhenies së gradës shkencore Doktor e më tej Senatit për miratimin përfundimtar.

## Neni 13

### Shpallja e njoftimit për hapjen e pranimeve në ciklin e tretë të studimeve të Doktoratës

1. Pas hapjes/riorganizimit të studimeve të doktoratës dhe miratimit të kuotave për vitin akademik nga MAS për programet ekzistuese apo ato të reja të Doktoratës, Rektori i UST-së, brenda 15 ditëve të punës, nxjerr urdhërin për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës. Në urdhërin e Rektorit specifikohet hapja e aplikimeve në studimet e doktoratës në UST si dhe afatet kohore, brenda të cilave do të kryhen këto aplikime.
2. Drejtuesi i njesisë kryesore brenda 5 ditë pune pas daljes së urdhërit të Rektorit, përgatit dhe shpall njoftimin për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës, në faqen zyrtare të UST-së dhe ja përcjell në rrugë zyrtare (Hard Copy ose elektronike) njësive kryesore të UST-së nëpërmjet Koordinatorit të Programit të Studimit.
3. Njoftimi përmban këto informacione:
  - a. Titulli/fusha kryesore e kërkimit i programit të Doktoratës (emërtimi duhet të jetë sipas Udhërit të MAS për hapje/riorganizim të shkollës së doktoratës);
  - b. Fushat/nënfushat e studimeve të doktoratës, sikurse të miratuara zyrtarisht nga organet e UST-së;
  - c. Kuotat e doktoratës në çdo fushë (kuotat duhet të jenë sipas përcaktimit në shkresën përcjellëse – Urdhër për njohje dhe zbatim të MAS);
  - d. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim
  - e. Afati për paraqitjen e aplikimit (në zbatim të Urdhërit të Rektorit të UST-së për hapjen e aplikimeve).
4. Shpallja e njoftimit/thirrjes për aplikime në programin e Doktoratës me kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimin në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të UST-së, si dhe në ambientet e tyre, të paktën një muaj përpara përfundimit të afatit për depozitimin e kërkesave.
5. Kriteret e pranimin nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.

## Neni 14

### Kërkesat themelore për aplikimin dhe pranimin e kandidatëve

1. Për t'u regjistruar në programin e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të përmbushë kriteret të përgjithshme,specifike dhe /ose preferenciale të miratuara dhe të shpallura në njoftimin publik.
2. Kriteret e përgjithshme të pranimin në programin/et e Doktoratës në UST paraqiten në **Shtojcën 2** bashkëngjitur kësaj rregullore. Nëse njësia kryesore/njësia bazë ka formuluar edhe kriteret specifike dhe ose/preferenciale, atëherë ajo i përfshin edhe këto kriteret specifike në shpallje si dhe në skemën e vlerësimit të kandidatëve.
3. Në kriteret e pranimin duhet të përcaktohen qartë kriteret skualifikuese, kriteret specifike dhe ato preferenciale
4. Për vlerësimin rendor të kandidatëve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues, njësitë bazë mund të propozojnë edhe kriteret specifike dhe/ose preferenciale si vijon:
  - a) Fusha prioritare të kërkimit;

- b) Nivele sasiore të kriterëve të përgjithshme: nota mesatare e studimeve të mëparshme, vlerësimi i gjuhës së huaj, publikime të mëparshme, etj.;
  - c) Prioritet kanë personeli akademik me kohë të plotë në njësitë bazë të UST-së;
  - d) Preferohet të punojë në fushën/nënfushën përkatëse;
  - e) Preferohet të këtë përfunduar programe kualifikime të tjera të ciklit të tretë si Master Ekzekutiv apo ekuivalent me to në drejtime që lidhen me temën e kërkimit;
  - f) Preferohet të këtë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
  - g) Preferohet të këtë marrë pjesë në aktivitete shkencore si dhe të këtë botime në fushën përkatëse;
  - h) Si dhe kriterë të tjera, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti.
5. Kriteret specifike dhe/ose preferenciale të miratuara përfshihen në thirrjen për aplikim; ato mund të ndryshohen por jo brenda të njëjtit cikël të plotë studimi.
  6. Aplikanti duhet të përmbushë edhe kriteret specifike nëse ato deklarohen si të detyrueshme.
  7. Dosja duhet të shoqërohet me Platformën Kërkimore, të plotësuar sipas **Shtojcës 3** dhe deklarimin e udhëheqësit shkencor plotësuar në formatin sipas **Shtojcës 4** bashkëngjitur kësaj rregullore.

## **Neni 15**

### **Aplikimi i kandidatit**

1. Pas shpalljes së konkursit publik për aplikimin në programet e studimit të doktoratës, Aplikanti brenda afatit të përcaktuar në urdhërin e Rektorit të UST-së, aplikon për t'u pranuar në studimet e doktoratës, me dosjen individuale.
2. Dosja e aplikantit, drejtuar njësisë bazë/kryesore përgjegjëse për programin e studimit të Doktoratës, dorëzohet pranë zyrës së protokollit të njësisë kryesore përkatëse/IAL-së.
3. Dosja individuale duhet të përmbajë të gjitha dokumentat e kërkuara sipas **Shtojcës 5** si dhe dokumentin e vërtetimit të pagesës së tarifës e aplikimit. Dosja duhet të përmbajë edhe një dokument me listën e saktë të gjithë dokumentacionit të dorëzuar dhe numrin e faqeve. Pasi verifikohet i gjithë dokumentacioni nga punonjësi përkatës pritës, një kopje e listës së dokumenteve të dorëzuar i kthehet aplikantit.
4. Brenda 1 (një) jave nga përfundimi i datës së aplikimeve, njësia kryesore përcjell dosjen e kandidatit në Departamentin përgjegjës për vijimin e mëtejshëm të procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

## **Neni 16**

### **Vlerësimi, renditja dhe përzgjedhja e kandidatëve**

1. Dosjet e kandidatëve aplikantë për programin e studimit të Doktoratës shqyrtohen e vlerësohen nga një komision *Ad-hoc*, i ngritur nga dekanati përkatës në përbërjen e të cilit janë të gjithë anëtarët e njësisë bazë, që mbajnë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.

2. Anëtarët në shumicë të këtij komisioni janë anëtarë të njësisë bazë, të kategorisë “Profesor”. Nëse kjo nuk plotësohet, mund të përfshihen antarë të tjerë personel akademik i brendshëm të njësisë kryesore të kësaj kategorie, specialistë të fushës përkatëse të kërkimit ose të fushave të përafërta.
3. Njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës me propozim të drejtuesit të saj, brenda 2 (dy) ditë pune nga data e marrjes së aplikimeve nga ana e drejtuesit të njësisë kryesore, i përcjell propozimin për anëtarët përkatës të komisionit “Ad-hoc”, për miratim drejtuesit të njësisë kryesore.
4. Në rastet e programeve me nënfusha specifike, dekanati mund të ngrejë komisione Ad-hoc edhe sipas nënfushave kërkimore.
5. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 2 (dy) ditë pune ngre komisionin “Ad-hoc” me anëtarët e propozuar nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe anëtarë të tjerë sipas pikës 2 të këtij neni. Ai mund të bëjë propozime për ndryshime të antëraëve të propozuar nga Njësia Bazë.
6. Komisioni “Ad-hoc” është përgjegjës për vlerësimin e dosjes së kandidatëve. Komisioni vlerëson dokumentacionin fizik dhe përmbajtjen e dosjes sipas metodologjisë dhe procedurave të vlerësimit e paracaktuara.
7. Skema dhe metodologjia e vlerësimit cilësor dhe sasior përkundrejt kritereve hartohet nga Njësia Bazë/Kryesore dhe më pas shqyrtohet e miratohet nga Komisioni i Përhershëm i dhenies së gradës shkencore “Doktor”.
8. Metodologjia dhe skema e vlerësimit me pikë të kandidatëve bëhet transparente dhe publikohet në faqen e internetit të cdo njësie kryesore/UST-së (Shtojca 6), së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.
9. Komisioni Ad-hoc kryen vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në dosjet e aplikimit, jo më vonë se 2 javë pas mbylljes së aplikimit të kandidatëve.
10. Komisioni Ad-hoc, pas verifikimit të përmbushjes së kritereve të përcaktuara, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, bën renditjen e aplikantëve kandidatëve, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin përkundrejt kritereve të përgjithshme dhe/ose specifike/preferenciale të publikuara.
11. Lista e kandidatëve fitues, të përzgjedhur nga Komisioni Ad-hoc, miratohet nga Njësia bazë brenda 5 (pesë) ditë pune.
12. Pas kësaj, njësia bazë përcjell listën me renditjen paraprake të kandidatëve dhe dosjet e tyre, drejtuesit të njësisë kryesore, i cili shpall listën me renditjen e kandidatëve.
13. Kandidati/ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve të renditur nga Komisioni Ad-hoc, ka të drejtë të ankimojë me shkrim renditjen në liste sipas vlerësimit të tij/saj, pranë protokollit të njësisë kryesore/IAL-së përkatëse.
14. Ankimimet, pasi i përcillen njësisë bazë brenda 5 (pesë) ditëve pune, shqyrtohen nga kjo e fundit brenda 5 (pesë) ditë pune nga afati i fundit i ankimit. Kjo e fundit i kthen përgjigje zyrtare të argumentuar ankimuesit, në përputhje me procedurat administrative përkatëse.

15. Brenda 5 (pesë) ditëve, njësia bazë përcjell drejtuesit të njësisë kryesore renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues.
16. Njësia kryesore përcjell në mënyrë zyrtare listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar në studimet e doktoratës pranë Rektoratit të UST-së
17. Lista e kandidatëve fitues shpallet në faqen zyrtare të njësisë kryesore përkatëse dhe UST-së si dhe në ambientet e saj.

### **Neni 17**

#### **Regjistrimi i Kandidatëve fitues**

1. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë mësimore të njësisë kryesore përkatëse të studimeve të doktoratës, brenda 2 (dy) javëve nga data e shpalljes së listës përfundimtare të kandidatëve fitues.
2. Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk regjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e vazhdimit të studimeve të doktoratës dhe në vend të tij, brenda një afati 5 (pesë) ditë regjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare.
3. Dokumentacioni i aplikimit të kandidatëve fitues depozitohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.
4. Kandidatëve jofitues, me kërkesën e tyre, ju kthehet dosja individuale me dokumentet e aplikimit, brenda 2 (dy) javëve, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.
5. Midis kandidatit fitues dhe përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore lidhet një kontratë tip.
6. Në momentin e regjistrimit në programin e studimeve të doktoratës, kandidati pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës, i cili pasqyrohet në regjistrin themeltar.
7. Në rastin kur studenti çregjistrohet nga një program studimi, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.
8. Në rastin kur studentit i pezullohet studimi, NIM-i nuk mbyllet dhe mbetet i njëjtë kur studenti e rifillon atë.

### **Neni 18**

#### **Afatet në lidhje me pranimin në ciklin e tretë të studimeve Doktoratë në UST**

1. Çdo njësi bazë duhet të përcaktojë kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues pëit vitin akademik pasardhës brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin specifik të Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Kuotat i përcillen Senatit Akademik të UST-së për miratim.
2. Çdo njësi kryesore ka detyrim të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga njësitet bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron. Këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.

3. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës publikohen në faqen zyrtare të internetit të cdo njësie kryesore dhe të IAL-së, si dhe në mjediset fizike, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.

## **KREU IV**

### **REALIZIMI I STUDIMEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË DOKTORATËS**

#### **Neni 19**

#### **Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të Doktoratës**

1. Kohëzgjatja e studimeve të ciklit të tretë të Doktoratës është nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) vite akademike. Afati i mbrojtjes së tezës së doktoratës, nuk duhet të kalojë 5 vite nga regjistrimi në program.
2. Gjatë viteve të rregullta të studimeve në programin e studimit të Doktoratës, kandidatët parashikohet të kryejnë disa veprimtari akademike-kërkimore në përmbushje të kriterëve e standardeve në fuqi.
3. Gjatë vitit të parë të studimeve, kandidatët zhvillojnë këto veprimtari akademike/kërkimore:
  - a. Kërkim dhe analizë të hollësishme të literaturës bazë dhe specifike ku mbështetet projekti kërkimor i paraqitur dhe miratuar për tu zhvilluar nga ana e kandidatit.
  - b. Përgatitja e një produkti të shkruar në formën dhe formatin e një revieë literature si rezultat i procesit të kërkimit sipas pikës a. Kjo veprimtari përgatitore i raportohet Departamentit përgjegjës brenda 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit të parë të studimeve dhe prezantohet në Departament, në praninë e Komisionit të Përhershëm për dhenien e gradës shkencore “Doktor”, ose një përfaqësie të tij.
  - c. Kërkim për hartimin e Metodologjisë së posaçme të projektit të kërkimit individual dhe raportimin e tij në Departamentin përgjegjës, sipas të njëjtës procedurë të pikës b më lart. Raportimi dhe prezantimi i Metodologjisë bëhet brenda 11 (njëmbëdhjetë) mujorit të vitit të parë të studimeve.
  - d. Raportimet gjatë vitit të parë bëhen sipas formateve të përcaktuara në **Shtojcave 7 dhe 8**, bashkëngjitur kësaj rregullore.
4. Gjatë vitit të dytë të studimeve kandidatët zhvillojnë këto veprimtari kërkimore:
  - a. Kërkim të mirëfilltë shkencor, zhvillimin e eksperimenteve, sikurse të parashikuara në projektin e platformën kërkimore dhe nën drejtimin e udhëheqësit shkencor përkatës.
  - b. Veprimtari për reflektimin e rezultateve të përfutuara në publikime shkencore si artikuj, prezantime në konferenca, në përmbushje të kriterëve të kërkuara për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

- c. Në përfundim të vitit të dytë kandidatët hartojnë në raport vjetor mbi ecurinë e punës kërkimore, arritjet dhe rezultatet pjesore si dhe produktet kërkimore konkrete të publikuara për dhenien e gradës shkencore, rezultatet e kërkimit dhe arritjen e objektivave dhe e paraqesin atë në Departament, brenda 10 (dhjetë) mujorit të vitit të dytë të studimeve. Rezultatet prezantohen përpara Departamentit, jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga fillimi i vitit të dytë të studimeve, në praninë e Komisionit të Përhershëm, për dhenien e gradës shkencore “Doktor”, ose një përfaqësie të tij.
- d. Raportimi për veprimtaritë kërkimore të vitit të dytë bëhen sipas formateve të përcaktuara në **Shtojcën 9**, bashkëngjitur kësaj rregullore
5. Gjatë vitit të tretë të studimeve, kandidatët kryejnë këto veprimtari:
  - a. Përfundimin e veprimtarisë kërkimore konkrete dhe përgatitjen për përpilimin e disertacionit.
  - b. Raportimin e mbylljes së kërkimit dhe përpunimit të rezultateve, sipas formatit në **Shtojcën 10**, bashkëngjitur kësaj rregullore.
  - c. Përpilimin dhe shkrimin e dizertacionit të doktoratës.
  - d. Plotësimin e dosjes së dizertacionit me dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore.
  - e. Mbrojtjen e disertacionit përpara Jurisë përkatëse të ngritur për këtë qëllim.
  - f. Depozitimin e dizertacionit sipas kërkesave në fuqi dhe në këtë rregullore.
6. Njësia bazë shqyrton ecurinë e punës së kandidatit, bazuar në prezantimet vjetore të punës që ai/ajo bën dhe realizon, produktet e kërkimit (botime shkencore, pjesëmarrje në evente shkencore).
7. Në fund të cdo viti të plotë 12 mujor (viti 1 dhe 2) dhe përpara fillimit të procesit të mbrojtjes së dizertacionit, koordinatori i programit të studimit harton një raport vjetor të arritjeve për cdo kandidat, i cili i paraqitet Njesisë Përgjegjëse për Programin dhe Komisionit të dhenies së gradës shkencore “Doktor”.
8. Për kandidatët me kohëzgjatje të studimeve mbi 3 (tre) vite, afatet e shlyerjes së detyrimeve dhe raportimeve të përcaktuara si më lart shtrihen proporcionalisht me kohën e përgjithshme të studimeve, sipas një plani individual të miratuar.

## **Neni 20**

### **Ndryshimi i udhëheqësit shkencor**

1. Kandidati ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e udhëheqësit të tij shkencor, kur ky/kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 7 të Nenit 11 të kësaj Rregullore.
2. Kërkesa për ndryshimin e udhëheqësit shkencor duhet të mbështetet në prova dokumentare të cilat provojnë qartë mosrespektimin e pikave 3, 4, 5 dhe 7 të nenit 11 nga ana e udhëheqësit shkencor.
3. Kandidati doktorant ka të drejtë që brenda semestrit të parë, të vitit të parë të studimeve doktorale, ti drejtojë kërkesën me shkrim Drejtuesit të njësisë bazë, i cili, brenda 15



- (pesëmbëdhjetë) ditëve shqyrton dhe i dërgon me shkrim të argumentuar, propozimin Drejtuesit të njësisë Kryesore në lidhje me kërkesën e bërë.
4. Drejtuesi i njësisë kryesore, i përcjell brenda 5 ditë pune këtë propozim Komisionit të dhënies së gradës shkencore “Doktor” për vendimmarrje.
  5. Komisioni pranon ose refuzon propozimin e paraqitur dhe shprehet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, me vendim të arsyetuar.
  6. Kur kërkesa e kandidatit për ndryshimin e udhëheqësit miratohet nga Komisioni, njësia bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë një udhëheqës të së njëjtës fushë /nënfushë të projektit kërkimor ekzistues fitues. Në rast se kjo është e pamundur dhe sjell si pasojë nevojën e ndryshimit të projektit kërkimor fitues, atëherë kandidatit i krijohet mundësia të hartojë e propozojë një projekt të ndryshuar brenda të njëjtës fushë kërkimore në kuadër të projektit kërkimor të programit të doktoratës të miratuar, dhe të ndjekë procedurën e shqyrtimit dhe miratimit sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
  7. Kandidati dhe udhëheqësi shkencor hartojnë programin e realizimit të veprimtarive kërkimore të projektit të ndryshuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe në afatet kohore të përcaktuara për përmbushjen e të gjitha veprimtarive akademike, të shtrira të paktën në 3 (tre) vite, duke filluar nga data e miratimit nga Komisioni.
  8. Procedura për miratimin e ndryshimit të temës kërkimore dhe programit kërkimor të kandidatit shqyrtohen dhe miratohen sipas procedurave të njëjta me ato më lart për ndryshimin e udhëheqësit shkencor vetëm pasi kanë marrë miratimin perkates zyrtar.

## **Neni 21**

### **Ndryshimi i temës kërkimore të disertacionit**

1. Në kushtet e nevojës dhe arsyeve objektive për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti duhet të paraqesë një kërkesë të argumentuar, drejtuar Përgjegjësit të Njësisë bazë, të nënshkruar prej tij dhe të miratuar nga udhëheqësi/t, përpara raportimit të parë në Njësinë Bazë.
2. Kërkesa drejtuar përgjegjësit të njësisë bazë, duhet të jetë e mbështetur në argumenta shkencorë dhe ligjore të cilët vërtetojnë pamundësinë e zhvillimit të kërkimit/projektit fitues. Në këtë kërkesë shprehet qartë nevoja dhe shkaqet e ligjshme që kanë detyruar kandidatin për të kërkuar ndryshimin e temës.
3. Pas shqyrtimit të kërkesës nga Drejtuesi i Njësisë bazë, ky i fundit harton një raport të detajuar rreth nevojës dhe shkaqeve të përligjura për këtë ndryshim dhe i përcjell Komisionit të Përhershëm, përmes Drejtuesit të Njësisë Kryesore, propozimin e tij në lidhje me kërkesën, jo më vonë se 2 javë nga marrja e kërkesës së kandidatit.
4. Komisioni i Përhershëm, brenda 10 ditëve nga marrja e propozimit, miraton ose refuzon ndryshimin e propozuar, duke u shprehur me vendim të argumentuar.

5. Ndryshimi i temës kërkimore të disertacionit mund të bëhet edhe në rastin e parashikuar në pikat 6, 7 dhe 8 të Nenit 20 të kësaj rregulloreje vetem pasi kane marre miratimin perkates zyrtar.

## **Neni 22**

### **Të drejtat dhe detyrat e studentit të doktoratës**

1. Studenti ka të drejtë:
  - a) të marrë informacion mbi bazën ligjore dhe akte rregullatore në fushën e doktoratave;
  - b) të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive të parashikuara në programin e studimeve;
  - c) të shfrytëzojë laboratorët, bibliotekën e fakultetit apo të njësisë përkatëse të kërkimit;
  - d) të shfrytëzojë burimet elektronike të informacionit pranë ambienteve të njësisë bazë/kryesore.
  - e) të aplikojë për të marrë pjesë në mobilitete/periudha kërkimi në institucionet me të cilat UST ka marrëveshje, kur këto mobilitete i dedikohen studentëve të doktoratës,
  - f) të tërhiqet vullnetarisht nga programi duke paraqitur kërkesën me shkrim;
  - g) Të paraqesë shqetësime apo ankime në lidhje me mbarëvajtjen e studimeve që nuk varen prej tij/saj.
2. Studenti ka për detyrë:
  - a) të njohë rregulloren e programeve të studimit të doktoratës dhe bazën ligjore përkatëse (VKM, Udhëzime të MAS etj)
  - b) të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligjet, vendimet, udhëzimet e rregulloret;
  - c) të ndjekë e realizojë deri në fund programin e miratuar të kërkimit të doktoratës;
  - d) të arrijë rezultate të larta në realizimin e programit të studimeve të doktoratës;
  - e) t'i shlyejë në kohën e duhur universitetit (fakultetit), të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga regjistrimi dhe vazhdimi i studimeve në programin e doktoratës;
  - f) të raportojë 2 (dy) herë në vit në njësinë bazë të programit (departament apo grup mësimesh shkencor) mbi ecurinë e punës për realizimin e programit;
  - g) të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën;
  - h) të përfundojë punimin brenda afateve të parashikuara.

## **KREU V**

### **MBROJTJA E DISERTACIONIT DHE DHENIA E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”**

#### **Neni 23**

##### **Kriteret për mbrojtjen e dizertacionit të Doktoratës**

1. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë përmbushur kriteret dhe arritur rezultatet e mëposhtme:
  - a) Të ketë përmbushur plotësisht kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi përpara mbrojtjes së dizertacionit (**Shtojca 11**).
  - b) Të ketë përfunduar dizertacionin, sipas formatit të përcaktuar në rregulloret e lidhura me programin e tij të studimit. Dizertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UST, në lidhje me Integritetin në Kërkimin Shkencor.
  - c) Të ketë marrë vlerësim pozitiv dhe miratimin nga udhëheqësi përkatës për realizimin e sa më sipër dhe përmbushjen e kriterëve për vijimin e procedurës së mbrojtjes të hartuar sipas **Shtojcës 12**.
  - d) Të shoqërojë cdo arritje me dokumentacionin evidentues.

#### **Neni 24**

##### **Procedura e ndjekur**

1. Koordinator i programit të studimit, mbështetur në arritjet e kandidatit harton për cdo kandidat një raport të përgjithshëm përfundimtar të ecurisë, përmbushjes së kriterëve të kërkuara, të detyrimeve akademike dhe financiare nga ana e kandidatit dhe ja përcjell Njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.
2. Dosja e kandidatit, që përmban dizertacionin, dokumentacionin që tregon plotësimin e kriterëve si më sipër, verifikohet, shqyrtohet dhe vlerësohet nga njësia bazë. Nëse ajo vlerësohet në përputhje dhe përmbushje të kriterëve të kërkuara, dhe pasi votohet nga antarësia e saj, i përcillet zyrtarisht drejtuesit të njesisë kryesore, për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.

#### **Neni 25**

##### **Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës**

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin stafit akademik të njësive bazë nga institucionet homologe vendase ose të huaja. Të paktën tre prej anëtarëve të jurisë duhet të kenë titullin "Profesor". Në rastet kur nuk mund të gjenden dy anëtarët e tjerë me këtë titull, pranohen anëtarë me titullin "Profesor i asociuar" dhe që kanë përvojë të mjaftueshme akademike e shkencore brenda dhe jashtë vendit.

2. Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë Rregullore, si edhe ka përfunduar disertacionin e tij, sipas kësaj procedure:
- a) Dosjet për marrjen e gradës shkencore "Doktor" paraqiten nga kandidatët në Zyrën e Protokollit të Njesisë Kryesore, për administrimin parësor nga ana e Dekanit. Disertacioni paraprak në 3 (tre) kopje, së bashku me dosjen, dorëzohet pranë drejtuesit të njesisë kryesore, i cili ia përcjell për verifikim të plotësimit të kriterëve formale, Përgjegjësit të programit të studimit të doktoratës, i cili shprehet brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike, nga data e marrjes;
  - b) Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit të përcaktuar në vijim në këtë Rregullore. Nëse Përgjegjësi i programit të studimit të doktoratës, konstaton se, punimi nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar, disertacioni i kthehet kandidatit për plotësimin e të gjitha kërkesave të formatit. Afati për plotësimin e kërkesave të formatit është 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e kthimit për plotësim;
  - c) Drejtuesi i njesisë kryesore, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, përcjell në njësinë bazë dosjen dhe disertacionin;
  - d) Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, drejtuesi i njesisë bazë në bashkëpunim me udhëheqësin e doktoratës, cakton dy recenzentë, një nga të cilët është personel akademik i njesisë bazë dhe një tjetër, personel akademik i jashtëm në të njëjtën fushë kërkimi. Recenzentët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, përgatisin recensën, që dorëzohet tek drejtuesi i njesisë bazë;
  - e) Drejtuesi i njesisë bazë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dorëzimi i recensave, organizon mbledhjen e njesisë bazë, në prani të kandidatit, i cili paraqet disertacionin e tij. Në mbledhje, recenzentët prezantojnë recensat e tyre dhe personeli akademik i njesisë bazë mund t'i drejtojë kandidatit pyetje dhe të japë sugjerime. Në varësi të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna, kandidatit i jepet jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kohë, për pasqyrimin e tyre në disertacion;
  - f) Pas vlerësimit nga udhëheqësi i doktoratës të plotësimit të detyrave të dhëna kandidatit dhe kontrollit antiplagjiaturë, drejtuesi i njesisë bazë, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga dorëzimi, disertacionin e korrigjuar dhe dosjen e kandidatit, ia përcjell, nëpërmjet Zyrës së Protokollit të Njesisë Kryesore, Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor";
  - g) Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ për dosjen dhe/ose disertacionin, doktoranti ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar jo më parë se 3 muaj dhe jo më vonë se 6 muaj pas datës së vlerësimit negativ.
  - h) Njësia bazë së bashku me dokumentacionin e doktorantit: dosja (ku përmbahen të gjithë dokumentet administrative lidhur me doktorantin si dhe kriteret e përmbushura), disertacioni, raporti antiplagjiaturë dhe autoreferati; përcjell tek drejtuesi i njesisë kryesore edhe propozimin me 8 anëtarë të jurisë: 5 të brendshëm dhe 3 të jashtëm.

- i) Autoreferati i përgatitur nga dizertanti, i punuar edhe në *slideshoë ppt*, i dërgohet në formë elektronike të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe në mbledhjen e radhës ku do diskutohet punimi, kandidati për marrjen e gradës shkencore "Doktor" duhet të jetë prezent pranë ambjentit ku zhvillohet mbledhja.
  - j) Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" kujdeset për mirëadministrimin e dosjes së kandidatit gjatë gjithë procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit në komisionin e përhershëm.
  - k) Nëse komisioni e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre Jurinë për vlerësimin e disertacionit. Si rregull, recenzentët përzgjidhen në juri si oponentë.
3. Komisioni përzgjedh anëtarët e Jurisë nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë, propozuar nga njësia bazë dhe e miratuar nga Drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor". Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, ku njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet kryetar i saj.
  4. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" i përcjell Dekanit të fakultetit vendimin për jurinë për mbrojtjen e doktoratës, mbi bazën e propozimit të njësisë bazë.
  5. Vendimi për miratimin e jurisë nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" i përcillet me shkresë njësisë bazë dhe kryetarit të jurisë nga Dekani i Fakultetit.
  6. Jurisë i vihet në dispozicion, përveç punimit të disertacionit dhe dosjes së kandidatit, edhe skeda individuale që pasqyron plotësimin e kriterëve ligjore për marrjen e gradës "Doktor", e cila duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët e jurisë.
  7. Oponentët, të cilët janë 2 nga 5 anëtarët e jurisë (një i jashtëm dhe një i brendshëm), japin vlerësimin me shkrim të disertacionit në jo më pak se 4 faqe format A4.
  8. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.
  9. Mbrojtja e doktoratës bëhet me pjesëmarrjen e plotë të Jurisë. Kur për arsye të përligjura njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, Drejtuesi i departamentit vë në dijeni Dekanin dhe Kryetarin e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" duke propozuar një datë tjetër për mbrojtje. Kur anëtari i jurisë nuk paraqitet as në datën e dytë, atëherë ai zëvendësohet nga një anëtar tjetër. Dekani merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes të doktoratës dhe/ose të anëtarit të jurisë, pas miratimit paraprak nga komisioni i përhershëm. Juria merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas njoftimit dhe miratimit paraprak nga Dekani dhe Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.
  10. Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e mbrojtjes.

11. Komisioni, pasi merr Raportin e Vlerësimit nga Juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme Drejtuesit të Njesisë Kryesore.
12. Në përfundim të procedurës dosjet e kandidatëve dhe i gjithë dokumentacioni i vlerësimit të tyre depozitohen në Arkiven e Njesisë Kryesore dhe UST-së.

## **Neni 26**

### **Mbrojtja e doktoratës**

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet, si rregull, e hapur, me përjashtim të rasteve kur, për natyrën e veçantë të çështjeve të trajtuara (sekrete, të dhëna konfidenciale etj.) duhet të bëhet e mbyllur. Drejtuesi i njesisë kryesore, me kërkesë të njesisë bazë, autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar, sipas propozimit të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.
2. Disertacioni prezantohet para Jurisë, e cila e vlerëson atë.
3. Procedura e mbrojtjes së disertacionit përfshin:
  - a) paraqitjen nga kryetari i jurisë të dokumentacionit të dosjes, përbërjes së jurisë dhe deklaramit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes;
  - b) paraqitjen e oponentëve. Oponentët japin vlerësimin me shkrim të disertacionit, ku saktësohet nëse punimi në tërësi i përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke iu kushtuar vëmendje vlerave origjinale, që paraqet punimi, si dhe duke vënë në dukje anët pozitive e negative (nëse ka të tilla) të tij.
  - c) pyetje nga anëtarët e jurisë dhe të pranishmit rreth disertacionit dhe oponentëve, drejtuar doktorantit;
  - d) diskutime;
  - e) sqarime eventuale nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor;
  - f) shpërndarjen e fletëvotimeve të hapura e të paplotësuara dhe votim i fshehtë për vlerësimin e doktoratës;
  - g) pasqyrimin në procesverbal të rezultatit të votimit dhe shpalljen e vendimit me shkrim.
4. Punimi vlerësohet me pikë, nga 0 – 100 pikë. 100-80% e pikëve të mundshme = “shumë mirë”, 79-65% e pikëve të mundshme = “mirë”, 64-50% e pikëve të mundshme = “mjaftueshëm”, 49% e më pak e pikëve të mundshme = ‘pakalueshëm”.
5. Pas mbrojtjes së doktoratës, Njësia Kryesore përcjell një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në bibliotekën shkencore të njesisë kryesore dhe një kopje në formatin elektronik në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
6. Pas realizimit me sukses të mbrojtjes së doktoratës; doktoranti fiton gradën shkencore “Doktor” dhe diploma firmoset nga Dekani i fakultetit përkatës dhe Rektori i UST-së.
7. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë i përcillet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe prej andej Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të UST-së.

## Neni 27

### **Pezullimi dhe ndërprerja e programit të studimeve të doktoratës**

1. Nëse doktoranti nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Dekanit kërkon shtyrjen e mbrojtjes për shkaqe të arsyeshme, atëherë mbrojtja konsiderohet e pezulluar. Dekani informon me shkrim Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, Jurinë dhe udhëheqësin shkencor mbi pezullimin e procedurës. Komisioni i përhershëm pasi shqyrton rastet, shprehet me vendim. Përsëritja e procedurës së mbrojtjes është e mundur vetëm 1 (një) herë brenda një periudhe nga 3 muaj deri në 6 muaj nga data e pezullimit.
2. Procedura e doktoratës pezullohet kur udhëheqësi shkencor jep dorëheqjen në rastet e pamundësisë së kryerjes të këtij funksioni si dhe kur rezultatet e arritura nga doktoranti nuk kanë përmbushur kërkesat dhe objektivat e përcaktuara në programin kërkimor të miratuar, pavarësisht punës së udhëheqësit, dhe që nuk garantojnë vazhdimin e suksesshëm të projektit kërkimor të miratuar në përmbushje të kriterëve akademike të përcaktuara.
3. Ndërprerja e studimeve të doktoratës, është procesi i ç’regjistrimit nga ky program, në këto raste:
  - a) Kur kandidati në mënyrë të vullnetshme heq dorë nga vazhdimi i studimeve;
  - b) Kur konstatohen sjellje të rënda dhe të përsëritura kundër standardeve të etikës kërkimore, pasi të jenë ndjekur procedurat e përcaktuara në aktet rregullatore në fuqi.
  - c) Kur konstatohet më pas në kohë, se kandidati nuk ka plotësuar kriteret për praninë, të ecurisë në programin përkatës të doktoratës dhe parregullsi të tjera të procesit.
  - d) Kalon kohëzgjatja maksimale e përcaktuar për përfundimin e programit të doktoratës dhe nuk ka pasur kërkesë nga kandidati, për shtyrjen ose pezullimin e afatit.
4. Kërkesat me shkrim për ndërprerje të studimeve të ardhura nga kandidati dhe/ose udhëheqësi shkencor merren në shqyrtim nga Drejtuesi i njësisë bazë. Njësia bazë përkatëse, për rastet e parashikuara në pikën 3, germa b), c) dhe d) të këtij neni, me kërkesë të udhëheqësit të doktoratës, ngre një komision *Ad-hoc* për të shqyrtuar ekzistencën e kushteve për ndërprerjen e këtij programi studimi, si edhe pasojat juridike apo financiare. Në vijim komisioni *Ad-hoc* përcjell vlerësimin e tij tek Drejtuesi i njësisë bazë, i cili ja përcjell këtë propozim Përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës. Pas marrjes së mendimit nga , drejtuesi i njësisë kryesore Komisioni i përhershëm i dhenies së gradës shkencore “Doktor”, merr vendimin përfundimtar.

## Neni 28

### **Anulimi i gradës shkencore “Doktor”**

1. Grada shkencore “Doktor” mund të anulohet në rastet kur vërtetohet se, në veprimtarinë shkencore, që ka shërbyer për fitimin e gradës shkencore, konstatohen sjellje dhe praktika të

papranueshme, në kundërshtim me parimet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, konkretisht:

- a) Fabrikim – sajm i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta;
  - b) Falsifikim - manipulim i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim;
  - c) Plagjiaturë - përdorim i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.
2. Grada shkencore “Doktor”, mund të anulohet kur vërtetohet se kandidati ka paraqitur të dhëna të pavërteta, ose i ka falsifikuar ato, me qëllim përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, për fitimin e saj apo të pakonfirmuara nga udhëheqësi shkencor;
  3. Vendimi merret me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” të njësive kryesore përkatëse, pas rekomandimit të dhënë nga komisioni *Ad-hoc*, i caktuar nga ky Komision, i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik të njësive kryesore, të kategorisë “Profesor”, të së njëjtës fushë ose fushave të përafërta.
  4. Përpara marrjes së vendimit, komisioni *Ad-hoc* njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi:
    - a) për akuzat e ngritura sipas pikës 1 dhe/ose 2 të këtij neni;
    - b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth akuzës së ngritur, si dhe një afat të arsyeshëm, deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
    - c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre.
  5. Pasi komisionit *Ad-hoc* t’i jetë vënë në dispozicion informacioni i kërkuar sipas germës b) të pikës 6, të kësaj dispozite, ky i fundit njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi, për datën kur do të shqyrtohet akuza e pretenduar, e cila nuk mund të caktohet më shpejt se 5 (pesë) ditë pune dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune, nga marrja e njoftimit.
  6. Procesi i verifikimit kryhet në mënyrë të panshme, gjithëpërfshirëse, konfidenciale, pa cënuar saktësinë dhe objektivitetin e procedimit.

## **Neni 29**

### **Rregullat për paraqitjen e disertacionit**

1. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*), në format të shtypur dhe elektronik. Në marreveshje me udhëheqesin/it disertanti mund të hartojë disertacionin edhe në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*). Përpara dorëzimit disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor.



2. Disertacioni duhet të plotësojë kërkesat e paraqitjes, formatimit dhe vëllimit sipas **Shtojcës 13**, bashkëlidhur kësaj rregullore.

### **Neni 30**

#### **Regjistrimi i gradës Doktor**

1. Grada shkencore “Doktor” regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe në regjistrin e brendshëm përkatës institucional të Universitetit të Sporteve, Tiranë.
2. Diploma e gradës shkencore “Doktor”, sipas formës dhe elementëve të miratuar nga Senati Akademik, lëshohet nga Universiteti i Sporteve, Tiranë dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit përkatës dhe Rektori, si rregull, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit zyrtar të numrit të regjistrimit nga AKKSHI.
3. Çdo njësi kryesore mban Regjistrin e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) Numri rendor.
  - b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet grada shkencore "Doktor".
  - c) Gjinia.
  - d) Datëlindja.
  - e) Shtetësia.
  - f) Emërtimi i institucionit/ve të arsimit të lartë ku personi ka kryer studimet e doktoratës.
  - g) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë, i njësisë kryesore dhe/ose njësisë bazë që ka dhënë gradën shkencore "Doktor".
  - h) Forma e studimit.
  - i) Numri i matrikullimit.
  - j) Data e regjistrimit në programin e studimit të Doktoratës.
  - k) Numri dhe data e Vendimit të jurisë për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
    - 1) Data e regjistrimit në regjistrin për Gradën Shkencore, pranë AKKSHI-t.
  - m) Tema e disertacionit.
  - n) Fusha e studimit dhe vlerësimi.

### **Neni 31**

#### **Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës**

1. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike. Afati i mbrojtjes së tezës së doktoratës, nuk duhet të kalojë 5 vite nga regjistrimi në program.
2. Për arsye të përligjura (sëmundje të rënda, fatkeqësi etj) kandidati mund t'i kërkojë njësisë bazë përkatëse shtyrje të afatit të përfundimit të studimeve të doktoratës duke paraqitur dhe dokumentuar edhe arsyet e kësaj shtyrjeje. Në cdo rast, shtyrja e afatit të përfundimit të

studimeve të doktoratës nuk mund të tejkalojë afatet ligjore maksimale për përfundimin e programit të studimit.

3. Periudha e pezullimit (shtyrjes) të afatit përlogaritet në afatin maksimal të përcaktuar nga ligji, për përfundimin e programit të doktoratës.
4. Në çdo rast, kërkesa për shtyrje/pezullim, duhet të jetë e miratuar nga udhëheqësi shkencor i doktoratës. Njësia bazë përkatëse, me kërkesë të udhëheqësit të doktoratës, ngre një komision *Ad-hoc* për të shqyrtuar ekzistencën e kushteve për shtyrjen/pezullimin e programit të studimit, si edhe pasojat juridike apo financiare. Në vijim, përmes drejtuesit të njësisë bazë, komisioni *Ad-hoc* përcjell propozimin së bashku me dokumentacionin justifikues për vendimmarrje, tek Përgjegjësi i programit të studimit të doktoratës.
5. Vendimin për pezullim e merr dekani i njësisë kryesore.

### **Neni 32**

#### **Veçoritë e organizimit të programeve të përbashkëta të doktoratës**

1. Universiteti i Sporteve të Tiranës mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një ose më shumë universitete të tjera (vendase ose të huaja), në bazë marrëveshesh, duke pasur parasysh si më poshtë:
  - a) Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilin prej universiteteve pjesëmarrëse;
  - b) Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin universitet për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës;
  - c) Caktimin e gjuhës në të cilën do të hartohet dhe paraqitet teza e doktoratës apo pjesë të saj, përcaktuar në marrëveshjen midis universiteteve, nëse njëri nga universitetet është i huaj;
  - d) Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilës njësi kryesore ku është zhvilluar tema;
  - e) Secili universitet i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi gradën “Doktor” ose të barasvlershëm me të, duke shënuar në diplomat përkatëse “Tezë doktorate në bashkëpunim me universitetin.....”.
2. Rregullimi i detajuar i këtyre programeve bëhet me rregullore të përbashkëta të posaçme, mbështetur në rregulloret përkatëse të institucioneve partnere.

### **Neni 33**

#### **Veçoritë e organizimit të programeve ndërdisiplinore të doktoratës**

1. Fakultetet e Universitetit të Sporteve të Tiranës mund të organizojnë programe ndërdisiplinore të studimit të doktoratës me një ose më shumë njësi kryesore të tjera të UST-së, në bazë marrëveshesh, duke pasur parasysh si më poshtë:

- a) Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilin prej fakulteteve përkatës.
- b) Fusha e kërkimit të jetë e përafërt
- c) Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin njësi kryesore për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës.
- d) Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilës njësi kryesore;
- e) Secila njësi kryesore i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi titullin “Doktor” ose të barasvlershëm me të, duke shënuar në diplomat përkatëse “Tezë doktorate në bashkëpunim me Fakultetin.....”.

### **Neni 34**

#### **Raporti Vjetor për Mbarëvajtjen e Programit të Doktoratës**

1. Koordinatori i programit të studimit mban dhe ruan të gjitha të dhënat që lidhen me kandidatët, udhëheqësit shkencorë, temat/projektet kërkimore që zhvillohen në kuadër të studimeve të programit në të gjitha vitet, raportet vjetore të progresit individual të kandidatëve dhe të gjithë dokumentacionit të kërkuar e që dëshmojnë pranimin, përparimin e kandidatëve gjatë studimeve dhe mbrojtjen e marrjen e gradës shkencore “Doktor”.
2. Bazuar në raportet vjetore individuale të kandidatëve dhe të udhëheqësve shkencorë, koordinatori përgatit në fund të çdo viti akademik, një Relacion të Përgjithshëm të programit ku përmbahen të dhënat e arritjeve të kandidatëve, statistikat sipas viteve të studimit aktive dhe masat e rekomandimet për përmirësim. Ky relacion, i formatuar sipas **Shtojcës 14** bashkëngjitur kësaj rregulloreje, i paraqitet njësisë bazë/kryesore, Komisionit të Përhershëm të dhenies së gradës shkencore “Doktor” dhe Senatit Akademik.
3. Raporti Vjetor i Programit të Doktoratës i përcillet Drejtuesit të Njësisë Kryesore, ndërsa ky i fundit, Komisionit të Përhershëm dhe Senatit të UST-së.

### **Neni 35**

#### **Mbi etikën e kërkimit**

1. Çdo disertacion duhet të reflektojë rregullat, që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në respektim të Etikës dhe Integritetit në kërkimin shkencor.
2. Kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij dhe se ka respektuar rregullat e mënjanimit të plagjaturës në kërkim (**Shtojca 15**).
3. Të gjitha kërkimet shkencore që kryhen në njerëz apo kafshë duhet të jenë në përputhje me dispozitat ndërkombëtare dhe kombëtare në fuqi për këto kërkime. Kjo përfshin dhe marrjen e pëlqimit përmes nënshkrimit individual të subjekteve humane që përfshihen në kërkim, apo të kujdestarëve të tyre kur janë të mitur apo të paftë ta bëjnë këtë. Për këto raste meret

paraprkisht miratimi nga Këshilli i Etikës të UST dhe nga cdo institucion tjetër i përfshirë kur kërkimi kryhet në një institucion tjetër apo në bashkëpunim .

4. Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme.
5. Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur Dekanit për veprime të mëtejshme.
6. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës së autorit dhe akte të tjera ligjore të aplikueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e të drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen që vjen pas titullit të punimit.

### **Neni 36** **Financimi**

Vlera financiare e doktoratës si rregull financohet nga kandidati por mund të mbulohet pjesërisht apo plotësisht edhe nga fondet për kërkim shkencor të IAL-se , nga grantet e punës kërkimore-shkencore, që financohen nga buxheti i shtetit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi dhe/ose nga institucione të tjera financuese dhe/ose nga burime të tjera publike dhe jopublike.

### **Neni 37** **Dispozita kalimtare**

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë studentët që do të regjistrohen në programet e studimit të doktoratës pas hyrjes në fuqi të saj. Për studentët që kanë filluar programin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të zbatohen vetem dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje pas regjistrimit.

### **Neni 38** **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Rregullorja e Komisioneve të Përhershme të Dhenies së Gradës Shkencore “Doktor” në UST, e miratuar me Vendimin Nr. 40, Datë 21.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Komisioneve të Përhershme për Dhenien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe Manualit për Procedurat për Aplikimin dhe Pranimin në Ciklin e Tretë të Studimeve të Doktoratës në UST”, shfuqizohet.
3. Shtojcat në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, me të cilën rregullohet edhe përdorimi i tyre:
  - Shtojca 1: Baza ligjore e programeve të studimit të Doktoratës

- Shtojca 2: Kriteret e përgjithshme të pranimit
- Shtojca 3: Formati i Platformës
- Shtojca 4: Formati i deklaramentit të udhëheqësit shkencor
- Shtojca 5: Dokumentacioni
- Shtojca 6: Skema e vlerësimit të kandidatëve aplikantë
- Shtojca 7: Formati i raportimit 1, viti 1
- Shtojca 8: Formati i raportimit 2, viti 1
- Shtojca 9: Formati i raportimit të vitit të dytë
- Shtojca 10: Formati i raportimit përpara mbrojtjes së disertacionit, viti 3
- Shtojca 11: Kriteret ligjore të arritjeve përpara mbrojtjes
- Shtojca 12: Formati i vlerësimit të udhëheqësit mbi ecurinë dhe përmbushjen e kriterëve përpara mbrojtjes së dizertacionit.
- Shtojca 13: : Rregulla të paraqitjes, formatimit dhe vëllimit të dizertacionit
- Shtojca 14: Formati i raportimit vjetor të programit të studimit të Doktoratës
- Shtojca 15: Formati i deklaramentit antiplagjaturë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**PROF. DR. AGRON KASA**

**SHTOJCA 1**  
**BAZA LIGJORE PËR PROGRAMIN E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË**  
**“DOKTORATË”**

1. Ligji nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*,
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 *“Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara Nga Institucionet e Arsimit të Lartë”*, i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 *“Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”*”, i ndryshuar;
4. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018 *“Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”*, i ndryshuar;
5. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 *“Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”*;
6. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021 *“Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*;
7. Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 52, datë 03.12.2015 *“Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”*, i ndryshuar;
8. Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 08.07.2019 *“Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”*;
9. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.09.2019 *“Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”*;
10. Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019 *“Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”*;
11. Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 *“Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”*, i ndryshuar;
12. Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 30.03.2020 *“Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”*;
13. Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 10.09.2018 *“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”*;
14. Statutin, Rregulloren dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me programet e ciklit të tretë “Doktoratë” të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

**SHTOJCA 2**  
**KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT TË KANDIDATËVE**  
**NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”**

1. Diplomë universitare “Master i shkencave” në UST;
2. Diplomë e sistemit të vjetër 4-vjeçar në UST;
3. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoratës ose në rregulloren e saj;
4. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
5. Mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DNP) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 4-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80 % e pikëve totale;
6. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SA i UST, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
7. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.
8. Vetëm kandidatet të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mesiperme , kualifikohen për fazën tjetër të vlerësimit.

**SHTOJCA 3**  
**FORMULAR PËR PROPOZIMIN E TEMËS KËRKIMORE SHKENCORE TË**  
**KANDIDATIT PËR STUDENT NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE TË**  
**DOKTORATURËS**

<b>Kandidati/Studenti-ja:</b>	
<b>Viti Akademik:</b>	

<b>Udhëheqësi Shkencor:</b>	
-----------------------------	--

<b>Tema e Projektit Kërkimor Shkencor</b>

<i>Fusha e Studimit</i>

<i>Nën-fusha e Studimit</i>

<i>Lloji i Studimit</i>

<i>Kohëzgjatja e Projektit Kërkimor</i>	<i>Data e Fillimit të Projektit Kërkimor</i>

<i>Abstrakti</i> (jo më shumë se 500 fjalë)

<i>Identifikimi i Problemit dhe Rëndësia e Zgjidhjes së tij</i> (duhet të shprehet qartë riveiw e literaturë mbështetëse për projektin dhe rëndësia e studimit, jo më shumë se 1000 fjalë)

<i>Qëllimi</i> (jo më shumë se 150 fjalë)

<i>Hipoteza-at</i> (qartë dhe sa më konçize)



**Objektivat e Projektit Kërkimor**  
(objektivat duhet të jenë të qarta dhe sa më konçize)

**Risia e Projektit**  
(origjinaliteti dhe veçantia e projektit duhet të marrin vëmendje të veçantë, jo më shumë 250 fjalë)

**Metodologjia**  
(të sqarohet metodat që do të përdoren gjatë punës kërkimore me referencat përkatëse nga literatura, ato duhet të jenë të qarta dhe sa më konçize)

**Rezultatet e Pritshme**  
(me rëndësi të veçantë është të përcaktohet qartë kontributi i kërkimit në përputhje me: fushën dhe nën-fushën e programit të doktoraturës në fjalë, jo më shumë se 500 fjalë)

**Përfituesit Direkt**  
(me pika, sa më konçiz)

**Përfituesit Indirekt**  
(me pika, sa më konçiz)

**Si do të Bëhen të Njohura Rezultatet/Produkti**  
(në veçanti të sqarohet kur dhe si do të realizohen dy botimet e detyrueshme për projektin kërkimor në harkun e 3 vjetëve të studimit të doktoraturës, jo më shumë 250 fjalë)

**Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e I**

(Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e veprimtarive të cilat duhet të përshkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rët përkatës, ndërsa M i referohet muajve)

Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
<b>Përshkrimi i Veprimtarive që do të Realizohen</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>
1-												
2-												
3-												
--												

**Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e II**

(Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e veprimtarive të cilat duhet të përshkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rët përkatës, ndërsa M i referohet muajve)

Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
<b>Përshkrimi i Veprimtarive që do të Realizohen</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>
1-												
2-												
3-												
--												

**Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e III**

(Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e veprimtarive të cilat duhet të përshkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rët përkatës, ndërsa M i referohet muajve)

Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
<b>Përshkrimi i Veprimtarive që do të Realizohen</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>	<b>M</b>
1-												
2-												
3-												
--												

**Buxheti i Projektit Kërkimor Shkencor**

(sipas zërave dhe në total – në lekë, me pika dhe sa më konçiz)

--

StuSdenti-ja Kandidat/Msc. Emri, Mbiemri	Datë	Nënshkrimi

Udhëheqësi Shkencor/Titulli Emri, Mbiemri	Datë	Nënshkrimi

**SHTOJCA 4**  
**FORMATI I DEKLARIMIT TË UDHËHEQËSIT SHKENCOR**

Tiranë, më ...../...../202..

**Lënda:** **Deklaratë e Udhëheqësit Shkencor** për drejtimin e **MSc.** ....., kandidat/e për pranim në programin e ciklit të tretë të Doktoratës pranë Fakultetit të ....., të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Unë e nënshkruari/a ....., personel akademik i brendshëm në Departamentin e ....., në Fakultetin/Institutin e ....., me titull akademik “.....” dhe aktualisht me funksion .....,

**DEKLAROJ**

se pranoj të jem Udhëheqësi Shkencor për kandidatin/en MSc. ...., në kuadër të ndjekjes së studimeve të ciklit të tretë të Doktoratës 202..-202..., për kryerjen e projektit kërkimor-shkencor me temë .....

Ky projekt kërkimor aplikohet në Fushën kryesore të kërkimit “.....”, nënfusha: “.....” ofruar nga *Fakulteti i* ....., në UST.

Deklaroj gjithashtu se aktualisht nuk mbuloj asnjë udhëheqje tjetër në kuadër të studimeve të ciklit të tretë të Doktoratës, brenda dhe jashtë UST.

**Prof.Dr.** .....

**SHTOJCA 5**  
**DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR PRANIM NË STUDIMET E CIKLIT TË**  
**TRETË “DOKTORATË”**

**(Përmbajtja e Dosjes Individuale)**

1. *Curriculum Vitae* personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse aplikanti ka të tilla;
2. kopje të noterizuar të diplomave të kërkuara sipas pikës 1, a. të nenit 6, të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga Ministria përgjegjëse për arsimin;
3. kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose certifikate të barasvlershme me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati zotëron një të tillë;
4. fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
5. 2 (dy) fotografi;
6. 2 (dy) rekomandime nga personel me titull akademik;
7. një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, në rastet e vetëfinancimit;
8. dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje të noterizuar) sipas pikës 1/b të nenit 6;
9. vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar, që dëshmon se aplikanti është personel akademik ose personel i përfshirë në kërkim shkencor;
10. deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
11. vendimi i njësisë bazë për fushat e kërkimit shkencor të njësisë;
12. vendimi i njësisë bazë për pranimin e dokumentacionit për aplikim;
13. propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë, që pritet të sjellë punimi, plani i punës kërkimore-shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
14. platforma e disertacionit dhe plani i punës i ndarë në vite, i hartuar nga kandidati dhe udhëheqësi shkencor;
15. mandat pagesa për tarifën e aplikimit;
16. vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
17. vetëdeklarim të aplikantit se nuk ka patur në të kaluarën shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës.

**\*Shënim: Dosja duhet të ketë inventar dorëzimi, i cili firmoset në momentin e dorëzimit nga kandidati aplikant dhe marrësi i protokollit.**

**SHTOJCA 6**  
**SKEMA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE APLIKANTË**

**REZULTATI I VLERËSIMIT DHE RENDITJA E KANDIDATËVE APLIKANTË PËR**  
**TU PRANUAR NË PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE**  
**“DOKTORATË” NË “.....”**

**Tabela 1: Dokumentacioni Fizik**

Nr	Kriteret	Aplikanti 1	Aplikanti 2	Aplikanti 3	Aplikanti 4	Aplikanti 5	Aplikanti...
1	<i>Kërkesa e kandidatit drejtuar njësisë bazë, që është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës</i>						
2	<i>Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën/nënfushën e përzgjedhur.</i>						
3	<i>Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/ pritshmëritë etj., në përputhje me fushën/nënfushën e studimit, të ofruar/shpallur</i>						
4	<i>Letër motivimi</i>						
5	<i>CV personale:</i>						
6	<i>Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka</i>						
7	<i>Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, të shoqëruara me suplementet e diplomave përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit të kenë vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria për arsimin.</i>						
8	<i>Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;</i>						
9	<i>Fotokopje të kartës së indentitetit/pasaportës</i>						
10	<i>Dy fotografi;</i>						
11	<i>Dy rekomandime nga persona të kategorisë “Profesor”;</i>						

12	<i>Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UST</i>						
13	<i>Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas legjislacionit në fuqi;</i>						
14	<i>Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar në institucione të tjera akademike</i>						
15	<i>Mandat pagese për tarifën e aplikimit</i>						
16	<i>Dokumentacion tjetër në përmbushje të kritereve specifike/fakultative</i>						
	<i>Dokumentacioni është i plotë Po/Jo</i>						

**\*Shënim:** *Vlerësimi i shkallës së plotësimit të dokumentacionit fizik bëhet me: PO/JO.  
Aplikantët që kanë mangësi në dokumentacion (pas verifikimit me njësinë bazë/kryesore), nuk do vijojnë në procesin e vlerësimit në përmbajtje dhe skualifikohen.*

**Tabela 2: Përmbushja e kritereve përmbajtësore**

Nr	Kriteret	Aplikanti 1	Aplikanti 2	Aplikanti 3	Aplikanti 4	Aplikanti 5	Aplikanti .....
1	<b>CV personale</b> Përvoja akademike e kërkimore a. Koha si staf i brendshëm akademik në UST b. Koha si staf i jashtëm në UST						
2	<b>Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla:</b> a. Artikuj shkencorë në periodikë ndërkombëtarë b. Artikuj shkencorë në periodikë kombëtarë c. Prezantime orale në konferenca ndërkombëtare d. Prezantime orale në konferenca kombëtare						
3	<b>Nota mesatare (mbi 8) e diplomave universitare të niveleve:</b> a. Bachelor b. Master i Shkencave c. Diplomat e Integruara të Nivelit të Dytë (ekuivalentuar sipas legjilacionit vendas) d. Diplomat e huaja të njohura/ ekuivalentuara						
4	<b>Formime të ciklit të tretë të studimeve</b> a. Diploma të ciklit të tretë Master Ekzekutiv b. Specializime afatgjatë						
5	<b>Gjuha/hët e huaja, sipas legjilacionit në fuqi:</b> a. Vlerësimi i gjuhës së huaj e një nga 5 gjuhët e BE (në nivelin C1); ka përparësi gjuha angleze b. Çdo gjuhë tjetër e dytë Vlefshmëria kohore e gjuhës						
6	<b>Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/ pritshtëritë etj., firmosur nga udhëheqësi sipas Aneksit</b>						

	<p>Propozimi është i plotë, përmban të dhëna për të gjitha fushat e kërkuara sipas formatit në Aneksin 3 dhe respekton kriteret e kërkuara të strukturës dhe vëllimit;</p> <p>a. Të gjitha fushat e kërkuara janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë</p> <p>b. Propozimi dhe hipoteza mbështeten në literaturë bashkëkohore e profesionale</p> <p>c. Projekti kërkimor do të mbështetet në punë eksperimentale laboratorike në UST dhe/ose homologe sipas marrëveshjeve zyrtare</p>						
7	<p><b><i>Dëgjesa/prezantimi i projektit/platformës kërkimore përpara Komisionit të Doktoratës</i></b></p> <p>a. Qartësia dhe konciziteti i paraqitjes së projektit</p> <p>b. Përvetësimi dhe rrjedhshmëria e paraqitjes</p> <p>c. Gjuha/terminologjia profesionale e përdorur</p> <p>d. Respektimi i kriterëve të kërkuara të strukturës dhe kohës së paraqitjes</p>						
8	<b><i>Kritere specifike/fakultative</i></b>						
	<b><i>Totali pikëve 100</i></b>						

***\*Shënim: Vlerësimi i përmbushjes në përmbajtje të kriterëve të mësipërme për çdo aplikant kandidat bëhet me pikë çdo anëtar i komisionit ad hoc, dhe diskutohen dhe miratohen përfundimisht në mënyrë kolegjale.***



**Tabela 3: Pikët sipas komponentëve/kritereve të vlerësimit – Vlerësimi Përfundimtar**

Nr	Kriteret	Aplikanti 1	Aplikanti 2	Aplikanti 3	Aplikanti 4	Aplikanti 5	Aplikanti .....
1	<i>Kërkesa e kandidatit drejtuar njësisë bazë</i>						
2	<i>Deklaratë e drejtuesit shkencor</i>						
3	<i>CV personale</i>						
4	<i>Lista e punimeve shkencore</i>						
5	<i>Nota mesatare (mbi 8) e diplomave universitare</i>						
6	<i>Formime të ciklit të tretë të studimeve</i>						
7	<i>Gjuha/hët e huaja</i>						
8	<i>Propozim për temën e kërkimit.</i>						
9	<i>Dëgjesa/prezantimi i projektit/platformës kërkimore</i>						
	<i>Totali pikëve 100</i>						

**Tabela 4: Renditja e aplikantëve kandidatë për t’u pranuar në programin e studimit të  
Doktoratës në “.....”**

Nr.	Emri mbiemri i aplikantit	Pikët e përgjithshme
1		
2		
3		
4		
5		
6		
...		
...		

**KOMISIONI Ad hoc**

1.....

2.....

3.....

Tiranë, më ...../...../.....

**SHTOJCA 7**  
**FORMATI I RAPORTIMIT 1: VITI I PARË I STUDIMEVE**  
**PËRMBLEDHJE E LITERATURËS**

Kandidatët duhet të përgatisin një përmbledhje të literaturës (review) ku janë mbështetur për të hartuar e zhvilluar projektin e tyre kërkimor. Literatura duhet të jetë kryesisht e 10 viteve të fundit dhe e publikuar kryesisht në gjuhë angleze. Duhet të argumentohet mirë vendi që zë projekti konkret në raport me kërkime të ngjashme në vende të tjera, kundrejt literaturës së cituar dhe pse kërkimi gjen vend, interes e rëndësi në realitetin shqiptar.

**1. Struktura e Raportit.**

Raporti duhet të ketë këtë strukturë:

- i. Hyrja (introduction);
- ii. Zhvillimi (development);
- iii. Konkluzioni (conclusion).
  - a. Konteksti i projektit, përmbledhja/abstrakti (rreth 800 – 1000 fjalë): në gjuhën angleze;
  - b. Hyrja (rreth 1000 – 1200 fjalë, 2.5 – 3 faqe): Vendi që zë projekti kërkimor në kontekstin e studimeve në nivel ndërkombëtar. Rëndësia e projektit kërkimor, si i përgjigjet kërkesave të vendit, të federatave, kërkimit universitar kombëtar, etj.;
  - c. Zhvillimi (rreth 7200 – 9000 fjalë, 18 – 21 faqe): kërkim i literature ndërkombëtare duhet të paraqesë fushën e përgjithshme të kërkimit, fushën e veçantë dhe atë të lidhur specifikisht me projektin e paraqitur, të përbashkëtat, kundërshtitë etj;
  - d. Konkluzioni (rreth 800 – 1200 fjalë, 2 – 3 faqe): paraqitet si rrjedhojë llogjike e analizës së mësipërme, metodologjia që nevojitet të aplikohet në kërkim, pyetjet dhe hipoteza/at e kërkimit;
  - e. Literatura: 20 – 30 zëra ky të paktën 70% e tyre t'i përkasin 10 viteve të fundit (paraqitet vetëm literature që ka lidhje me kërkimin dhe që është cituar në tekst).

**2. Formati dhe shkrimi:**

Shkrimi duhet të jetë Times New Roman 12, me hapësira 1.5.

Teksti mund të përmbajë edhe tabela ose grafikë por të përkthyer në shqip dhe burimi nga janë marrë (këto nuk mund të zenë më shumë se 20% të materialit të plotë).

Literatura të paraqitet sipas formatit APA style.

**3. Procedura dhe Afatet**

- a. Raporti përgatitet si në formë shkresore ashtu dhe elektronike në formatin PDF.
- b. Raporti i përcillet zyrtarisht Njesisë Bazë/Kryesore/Komisionit, brenda datës 6 mujorit të parë, në 2 (dy) kopje.
- c. Raporti duhet të jetë i firmosur nga kandidati dhe drejtuesi i tij shkencor
- d. Kandidatët prezantojnë përpara komisionit raportin e parë brenda dy javësh pas përcjelljes zyrtare.
- e. Departamenti njofton kandidatët për formatin dhe kriteret e prezantimit të paktën 4 javë përpara datës së caktuar për prezantim.

**Kandidati**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Drejtuesi Shkencor**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Data ...../...../ 202...**

## **SHTOJCA 8**

### **FORMATI I RAPORTIMIT 2: VITI I PARË I STUDIMEVE**

### **METODOLLOGJIA E KËRKMIT**

Kandidatët duhet të përgatisin një material të shkruar që përmban Materialet dhe Metodën e temës së tyre kërkimore, ashtu sic janë konsultuar nga literatura ekzistuese, e lidhur me projektin kërkimor në fjalë dhe që kandidati nën drejtimin eudhëheqësit, parashikon që të zbatohet në këtë projekt. Në këtë raportim mund të parasikohen edhe zhvillime të metodave ekzistuese apo zbatim i përshtatur i metodave ekzistuese. Metodat duhet të jenë bashkëkohore, por duhet marrë parasysh edhe mundësia konkrete e zhvillimit të tyre në kontekstin e mundësive të Universitetit, laboratoreve të jashtme nëse kjo parashikohet në projekt apo mundësi zhvillimi (financimi) edhe në kuadër të vetë temës. Në temat kërkimore, që mund të kenë ndër qëllimet/objektin e tyre zhvillim apo përshtatje të metodologjive në kërkim apo në zbatim në një fushë të rëndësishme ku këto mungojnë, ky raportim duhet të jetë i detajuar duke përfshirë edhe këtë aspekt dhe pse ky component kërkimi gjen vend, interes e rëndësi në realitetin shqiptar

#### **1. *Struktura e Raportit.***

Raporti duhet të ketë këtë strukturë:

- f. Materiali: ku do të zhvillohet kërkimi; subjektet njerëzore, student, sportistë, përfaqësues të popullatës, komunitetit, grupmosha, grupe specifike, të tjerë (rreth 500- 700 fjalë). Duhet të sqarohet pse ka rëndësi që ky studim të zhvillohet në këto subjekte dhe pse kjo ka interes kombëtar apo më gjerë.
- g. Numri i subjekteve: duhet të saktësohet që numri i subjekteve të zgjedhura është kampion statistikisht përfaqësues i target grupit ku zhvillohet kërkimi, duke përdorur llogaritës ndërkombëtarë me koeficient besueshmërie (confidence) mbi 96% (100-200 fjalë).
- h. Metodën: duhet të përshkruhet se si metodat e përdorura janë në funksion të qëllimit e objektivave kërkimore (100-200 fjalë).
- i. Metodën që parashikohet të përdoren për realizimin e studimit, metoda laboratorike nëse ka, teste lëvizore/sportive, terreni, në kushte të vecanta (lartësi, ipobarike, etj), etj (3,000 – 4,000 fjalë)
- j. Nëse projekti ka për qëllim përdorim për herë të parë të metodave në vendin tonë, përshtatje të metodave në zbatim apo zhvillim të metodave të reja/të përmirësuara, duhet të sqarohet se çfarë risie kjo sjell për projektin/kërkimin (1500-2000 fjalë)
- k. Literatura ku është mbështetur hulumtimi për metodat që parashikohen të përdoren. Ato duhet të kenë të bëjnë drejtpërdrejt më metodat. Nëse ka të tilla edhe në Literaturën e Raportimit 1, ato të riparaqiten këtu dhe shtohen me ato specifike për metodat (deri në 20 zëra literature).

#### **2. *Formati dhe shkrimi:***

Shkrimi duhet të jetë Times Neë Roman 12, me hapësira 1.5

Teksti mund të përmbajë edhe tabela ose grafikë por të përkthyer në shqip dhe burimi nga janë marrë (këto nuk mund të zenë më shumë se 20% të materialit të plotë)

Literatura të paraqitet sipas formatit APA style.

#### **3. *Procedura dhe Afatet***

- a. Raporti përgatitet si në formë shkresore ashtu dhe elektronike në formatin PDF
- b. Raporti i përcillet zyrtarisht Njesisë Bazë/Kryesore/Komisionit, brenda 5 (pesë) muajve nga raportimi i parë, në 2 (dy) kopje
- c. Raporti duhet të jetë i firmosur nga kandidati dhe drejtuesi i tij shkencor
- d. Raporti prezantohet në department.
- e. Departamenti njofton kandidatët për formatin dhe kriteret e prezantimit të paktën 4 javë përpara datës së caktuar për prezantim.

**Kandidati**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Drejtuesi Shkencor**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Data ...../...../ 202..**

## SHTOJCA 9

### FORMATI I RAPORTIT 3: VITI I II-TË I STUDIMEVE ARRITJET DHE REZULTATET E KËRKIMIT

Kandidatët duhet të përgatisin një material të shkruar që përmban arritjet dhe rezultatet e kërkimit të kryertë realizuara gjatë vitit të dytë të studimeve, si dhe përfundime të pjesshme për punën e kryer. Analiza e arritjeve dhe rezultatet analizohen përkundrejt veprimtarive të parashikuara në planin individual të kandidatit për tu zhvilluar gjatë periudhës që mbulon raportimi.

Raportimi duhet të informojë edhe mbi arritjet në veprimtari të tjera të parashikuara për përmbushjen e kritereve për kandidatët Doktor si botime artikuj shkencorë, pjesëmarrje në veprimtari shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe të tjera që lidhen me temën e kërkimit të Doktoratës.

Në raportim mund të shprehen dhe mosarritje, shqetësime, problematika të dala e të paparashikuara si dhe rrugët e mënyrat për ti anashkaluar, për të mos ndikuar në realizimin e programit individual vjetor dhe gjithëvjetor.

#### **1. *Struktura e Raportit.***

Raporti duhet të ketë këtë strukturë:

- a. Arritjet dhe rezultatet e pjesshme të kërkimit (rreth 1000 – 2000 fjalë). Duhet të sqarohet se c’vend zenë këto në realizimin e plotë të kërkimit konkret dhe nëse ka vonesa apo mospërmbushje të pritshmërive sipas planit individual të kandidatit
- b. Nëse ka ndryshime të metodologjisë, numrit apo llojit të subjekteve dhe arsyt objective të këtyre ndryshimeve (100 – 200 fjalë, nëse ka).
- c. Veprimtari botuese që lidhet drejtpërdrejt me kërkimin në kuadër të temës së Doktoratës; artikuj shkencorë të botuar, pranuar për botim apo dërguar për botim. Këtu duhet të saktësohet se çfarë pjese e punimit është përfshirë në to (100 – 200 fjalë).
- d. Pjesëmarrje në veprimtari, konferenca e evente shkencore ku janë paraqitur pjesë e punimit të kryer, lloji i pjesëmarrjes (prezantim me gojë, poster) dhe botim në Book of Abstracts, artikull conference (conference paper në Proceeding). Këtu përfshihen të gjitha detajet që lidhen me klasifikimin e konferencave sipas kritereve të kërkuara për gradën shkencore “doctor”.
- e. Literatura, nëse ka ndryshime apo shtesë e dituar nga puna konkrete kërkimore gjatë periudhës që mbulon raportin.
- f. Në raportimin e dytë të vitit të dytë kandidati duhet të shprehet nëse është përfunduar puna kërkimore apo ajo parashikohet të përfundohet gjatë vitit të tretë, duke specifikuar kohën e saktë, në përputhje me afatet e parashikuara për këtë vit.

#### **2. *Formati dhe shkrimi:***

Shkrimi duhet të jetë Times New Roman 12, me hapësira 1.5

Teksti mund të përmbajë edhe tabela ose grafikë por të përkthyer në shqip dhe burimi nga janë marrë (këto nuk mund të zenë më shumë se 20% të materialit të plotë)

Literatura të paraqitet sipas formatit APA style.

#### **3. *Procedura dhe Afatet***

- a. Raporti përgatitet si në formë shkresore ashtu dhe elektronike në formatin PDF

- b. Raporti i përcillet zyrtarisht Njesisë Bazë/Kryesore/Komisionit, në përfundim të vitit të dytë të studimeve, por jo më vonë se 11 muaj nga fillimi I këtij vitit studimor dhe në 2 (dy) kopje
- c. Raporti duhet të jetë i firmosur nga kandidati dhe drejtuesi i tij shkencor
- d. Raporti prezantohet në department.
- e. Departamenti njofton kandidatët për formatin dhe kriteret e prezantimit të paktën 4 javë përpara datës së caktuar për prezantim.

Departamenti njofton kandidatët për formatin dhe kriteret e prezantimit të paktën 4 javë përpara datës së caktuar për prezantim.

**Kandidati**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Drejtuesi Shkencor**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Data ...../...../ 202..**

## SHTOJCA 10

### FORMATI I RAPORTIMIT 4, VITI I III-TË I STUDIMEVE

Kandidatët duhet të përgatisin një material të shkruar që përmban arritjet dhe rezultatet e kërkimit të kryer brenda 5-mujorit të vitit të tretë, nëse është kryer i tillë gjatë kësaj periudhe dhe kur është raportuar në raportimin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Në rstat se kjo raportohet, kandidati duhet të deklarojë përfudnimin e punës kërkimore individuale dhe të gjitha rezultatet e arritura sikurse parashikuar në planin e tij individual dhe në përputhje me veprimtaritë e pritshme të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe përfundimet të pjesshme për punën e kryer. Raportimet duhet të përfshijë edhe veprimtari të tjera të parashikuara për përmbushjen e kriterëve për kandidatët Doktor si botime artikuj shkencorë, pjesëmarrje në veprimtari shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe të tjera që lidhen me temën e e kërkimit të Doktoratës.

Në raspotim mund të shprehen dhe mosarritje, shqetësime, problematika të dala e të paparashikuara si dhe rrugët e mënyrat për ti anashkaluar, për të mos ndikuar në realizimin e programit individual vjetor dhe gjithëvjetor, duke theksuar ato që mund të ndikojnë në mosrespektimin e afateve për përmbushjen e kriterëve për mbrojtjen e disertacionit në përputhje me afatet ligjore dhe ato të parashikuara në këtë rregullore.

#### **1. *Struktura e Raportit.***

Raporti duhet të ketë këtë strukturë:

- g. Arritjet dhe rezultatet e pjesshme të kërkimit (rreth 1000-2000 fjalë). Duhet të sqarohet se ç'vend zenë këto në realizimin e plotë të kërkimit konkret dhe nëse ka vonesa apo mospërmbushje të pritshmërive sipas planit individual të kandidatit. Për cdo veprimtari të deklaruar duhet të sillen të dhëna të hollësishme për revistat shkencore, emërtimi, të dhënat e indeksimeve, vëllimi i botimit, etj.
- h. Veprimtari botuese që lidhet drejtpërdrejt me kërkimin në kuadër të temës së Doktoratës; artikuj shkencorë të botuar, pranuar për botim apo dërguar për botim. Këtu duhet të saktësohet se çfarë pjese e punimit është përfshirë në to (100-200 fjalë).
- i. Pjesëmarrje në veprimtari, konferenca e evente shkencore ku janë paraqitur pjesë e punimit të kryer, lloji I pjesëmarrjes (prezantim me gojë, poster) dhe botim në Book of Abstracts, artikull conference (conference paper në Proceeding). Këtu përfshihen të gjitha detajet që lidhen me klasifikimin e konferencave sipas kriterëve të kërkuara për gradën shkencore "doctor".
- j. Në raportimin e dytë të vitit të dytë kandidati duhet të shprehet nëse është përfunduar puna kërkimore apo ajo parashikohet të përfundohet gjatë vitit të tretë, duke specifikuar kohën e saktë, në përputhje me afatet e parashikuara për këtë vit.

#### **2. *Procedura dhe Afatet***

- a. Raporti përgatitet si në formë shkresore ashtu dhe elektronike në formatin PDF
- b. Raporti i përcillet zyrtarisht Njesisë Bazë/Kryesore/Komisionit, në përfundim të vitit të dytë të studimeve, por jo më vonë se 11 muaj nga fillimi I këtij vitit studimor dhe në 2 (dy) kopje
- c. Raporti duhet të jetë i firmosur nga kandidati dhe drejtuesi i tij shkencor
- d. Raporti prezantohet në department.

- e. Departamenti njofton kandidatët për formatin dhe kriteret e prezantimit të paktën 4 javë përpara datës së caktuar për prezantim.

**Kandidati**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Drejtuesi Shkencor**  
**Emër mbiemër**  
Firma

**Data ...../...../ 202..**



**SHTOJCA 11**  
**KRITERET E ARRITJEVE PËRPARA MBROJTJES**

1. Përpara se të paraqesë kërkesën për fillimin e procedurës së mbrojtjes së disertacionit, kandidati duhet të ketë plotësuar këto kushte dhe realizuar arritjet si më poshtë:
  - a) Të ketë përfunduar të gjithë punën kërkimore, të dokumentuar përmes raportimeve dhe të miratuara paraprakisht nga Departamenti/Njësia kryesore.
  - b) Të ketë marrë vlerësim pozitiv e pa vërejtje nga udhëheqësi shkencor që vërteton se kandidati ka realizuar plotësisht punën kërkimore dhe arritjet cilësore për mbrojtjen e disertacionit.
  - c) Të ketë përgatitur në formën përfundimtare të disertacionit të Doktoratës sipas të gjitha kritereve të formatimit, vëllimit e përmbajtjes sikundër parashikuar në këtë rregullore.
  
2. Të ketë realizuar:
  - a) Së paku, 3 (tre) referime ose paraqitje shkencore, si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, nga të cilët dy referime ose paraqitje të jenë mbajtur në një veprimtari shkencore/profesionale ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD, ose të G-20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je ose ISSN-je;
  - b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në *Journal Citation Reports* ose *Scopus*, ku është së paku autor i dytë.
  
3. Të ketë plotësuar dosjen individuale me të gjitha provat dhe evidencat dokumentare që vërtetojnë në mënyrë të plotë e të saktë përmbushjen e kritereve të mësipërme.

**SHTOJCA 12**  
**FORMATI I VLERËSIMIT TË KANDIDATIT NGA UDHËHEQËSI/T SHKENCOR/Ë**

<b>RAPORTI VJETOR I UDHËHEQËSIT PËR PËRPARIMIN E DOKTORANTIT</b>			
<b>Emërtimi i studimit të doktoratës:</b>			
<b>UDHËHEQËSI/T</b>			
<b>UDHËHEQËSI/T)</b>	<b>Titulli, emri e mbiemri:</b>	<b>Institucioni, shteti:</b>	
<b>Udhëheqësi i parë:</b>			
<b>Udhëheqësi i dytë:</b>			
<b>Emri e mbiemri doktorantit:</b>			
<b>Numri personal i doktorantit:</b>		<b>Viti akademik për të cilin jepet raporti:</b>	
<b>Në shkallën prej 1 – 5 shprehni vlerësimin tuaj për cilësinë e takimeve me doktorantin:</b>	1 – pamjaftueshëm;    2 – mjaftueshëm;    3 – mire;    4 – shumë mire;    5 – shkëlqyeshëm.		
<b>Nëse jeni përgjigjur me 1 ose 2 në pyetjen paraprake, arsyetoheni dhe propozoni si të bëhet përmirësimi:</b>			
<b>A është përpiluar plani i punës dhe a po realizon përparim doktoranti sipas planit? (shënoni katrorin)</b>	Përpilimi i planit të punës:	Ka bërë përparim në bazë të planit:	
	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<b>Nëse jo, trego shkaku dhe propozoni si të bëhet përmirësimi:</b>			
<b>Vlerësimi i cilësisë së përparimit të punës kërkimore të doktorantit</b>	1 – pamjaftueshëm;    2 – mjaftueshëm;    3 – mire;    4 – shumë mire;    5 – shkëlqyeshëm		

<b>Nëse jeni përgjigjur me 1 ose 2 në pyetjen paraprake, arsyetoheni dhe propozoni si të bëhet përmirësimi:</b>						
<b>Komenti mbi përparimin e doktorantit prej raportit të fundit:</b>						
<b>VLERËSIMI PËR DOKTORANTIN</b>						
<b>Ju lutemi që në shkallën prej 1 – 5 të vlerësoni:</b> <i>(1 – pamjaftueshëm 2 – mjaftueshëm, 3 – mirë, 4 – shumë mirë, 5 - shkëlqyeshëm)</i>	Përgatitjen e doktorantit për konsultime	1	2	3	4	5
	Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve hulumtuese në përsosjen profesionale	1	2	3	4	5
	Përparimi në metodologjinë e kërkimit shkencor	1	2	3	4	5
	Përpilimi dhe botimi i punimeve shkencore	1	2	3	4	5
	Qëndrimi i doktorantit ndaj punës kërkimore në përgjithësi	1	2	3	4	5
<b>Në shkallën prej 1 - 5 vlerësoni cilësinë e punës së doktorantit:</b>	1 – pamjaftueshëm; 2 – mjaftueshëm; 3 – mire; 4 – shumë mire; 5 – shkëlqyeshëm.					
<b>Nëse jeni përgjigjur me 1 ose 2 në pyetjen paraprake, arsyetoheni dhe propozoni si të bëhet përmirësimi:</b>						
<b>VENDIMMARRJA PËR VAZHDIMIN E STUDIMIT</b>						
<b>A mund t'i vazhdojë studimet doktoranti?</b>	a) po b) po, por me disa kushte c) jo					
<b>Në rast se në pyetjen paraprake jeni përgjigjur me b ose c, arsyetoheni:</b>						

**Vërejtje të tjera  
dhe mendimi i  
Udhëheqësit /  
bashkëmentorëve**  
*(sipas nevojës):*

**Vendi, data dhe nënshkrimi**

Tiranë, \_\_\_\_\_.

Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
*(Emri e mbiemri i Udhëheqësit)*

Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
*(Emri e mbiemri i Udhëheqësit të dytë)*

**SHTOJCA 13**  
**RREGULLA TË PARAQITJES, FORMATIMIT DHE VËLLIMIT TË**  
**DIZERTACIONIT**

- a) Lloji i shkrimit që duhet të përdoret në disertacion, është Times New Roman, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she, formatimi *justify*, hapësirë ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), përveç rasteve kur në këtë Rregullore kërkohet ndryshe.
- b) Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

- Margjina e sipërme	1”
- Margjina e poshtme	1”
- Margjina e majtë	1.25”
- Margjina e djathtë	1.25”
- c) Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.
- d) Parathënia duhet të shtypet me shkronja korsive.
- e) Hyrja duhet të ketë numra romakë.
- f) Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.
- g) Faqet e bibliografisë, ëve duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrit të faqeve të studimit.
- h) Shënimet në tekstin e disertacionit, bëhen në fund të faqes (footnote), me program kompjuterik.
- i) Tabelat e përfshira në tekst, duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i tabelave në disertacion bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala “Tabelë”, numri i tabelës dhe legjenda, duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate ose referime, ato duhet të vendosen në *foot note*. Si rregull, në shkrimin brenda tabelës, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she dhe hapësirë ndërmjet rreshtave 1.5 (një pikë pesëmbëdhjetë), *justify*, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tabelës.
- j) Diagramat, fotografitë, ilustrimet dhe grafikët, pasqyrohen në tekst me emërtimin “Figurë”. Çdo figurë, i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i figurave bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala “Figurë”, numri i saj dhe legjenda, vendosen poshtë. Nëse një figurë përmban citate ose referime, ato duhet të vendosen në *foot note*. Si rregull, në emërtimin e figurave, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she dhe hapësira ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), *justify*, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tyre. Përgjithësisht figurat, nuk duhet të kalojnë një faqe. Nëse ato vazhdojnë në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli si për tabelat.
- k) Materialet shoqëruese - Nëse një punim përmban materiale shoqëruese të tilla, si: CD, disketa kompjuteri, video ose kaseta etj. që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t’i bashkëngjiten punimit.
- l) Shtypja - Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e fletës. Të gjitha kopjet e disertacionit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Nuk pranohen dorëshkrimet.
- m) Lloji i letrës - Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.
- n) Disertacioni në variantin e tij final, lidhet në pesë kopje origjinale.
- o) Në kapakun e përparmë të kopertinës të disertacionit, duhet të vendoset:
  - Emri i universitetit (në krye, në mes të kopertinës);

- Emri i njësisë kryesore (në krye, mes të kopertinës);
  - Emri i njësisë bazë, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);
  - Logo e universitetit (në krye, në anën e majtë të kopertinës);
  - Logo e njësisë kryesore (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);
  - Fjala DISERTACION (në mes të kopertinës me germa kapitale, fonti i germës 20);
  - Emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);
  - Emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
  - Emri dhe grada e udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
  - Qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).
- p) Pjesa e pasme e kopertinës duhet të përmbajë:
- **Abstraktin në shqip dhe në anglisht.** Secili variant duhet të përmbajë 200 fjalë duke u përdorur masa 10–she e shkronjës. Ky element duhet t’u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.
  - **Fushën dhe fjalët kyçe.** Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

❖ **Formati i disertacionit përfundimtar të doktoratës në UST (i bashkëngjitet shtojcës 13).**

**SHTOJCA 14**  
**FORMATI I RAPORTIMIT VJETOR TË ECURISË SË PROGRAMIT TË DOKTORATËS**

RELACION VJETOR I ECURISË SË PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË “...”									
TË DHËNAT E PËRGJITHSHME									
Fakulteti/departamenti përgjegjës									
Adresa:									
Tel./email:					Viti akademik për të cilin jepet raporti:				
Emërtimi i programit të studimit:									
Përgjegjësi programit të studimit:									
TË DHËNAT E STUDIMIT TË DOKTORATËS									
Të dhëna të kandidatëve/ studentëve	Numri i të regjistruarve		Nga UST	Nga IAL të tjera	Nga institucione të tjera	Gjithsej			
	<i>Me kohë të plotë</i>	<i>Me kohë të pjesshme/part-time</i>							
Numri									
UDHËHEQËSIT SHKENCORË									
		Universiteti i Sporteve të Tiranës	Nga IAL kombëtare	Nga IAL ndërkombëtare	Të tjerë				
		Numri							
Profesorë doktorë rregullt:									
Profesorë të asociuar asocuar:									
GJITHSEJ (A):									
STRUKTURA E DOKTORANTËVE SIPAS LLOJIT STUDIMOR									
Viti akademik	Numri i doktorantëve të regjistruar në programin e studimit								
	Viti 1.			Viti 2.			Viti 3.		
	<i>me kohë të plotë</i>	<i>me kohë të pjesshme</i>	të jashtëm	<i>me kohë</i>	<i>me kohë të pjesshme</i>	të jashtëm	<i>me kohë të plotë</i>	<i>me kohë të pjesshme</i>	të jashtëm
Numri i temave të aprovuara të doktoraturës		Numri i doktoraturave të mbrojtura		Moshë mesatare e doktorantëve të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës			Mesatarja e kohëzgjatjes së studimeve ( <i>në vite</i> )		
STRUKTURA E DOKTORANTËVE SIPAS LLOJIT TË FINANÇIMIT TË STUDIMIT DHE GJINISË									
Lloji i financimit të studimit	Viti 1.		Viti 2.		Viti 3.		Kanë doktoruar		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Nga IAL									
IAL & vetëfinancim									

<b>Vetëfinancimi</b>								
<b>GJITHSEJ:</b>								
<b>UDHËHEQJA SHKENCORE</b>								
Numri i udhëheqësve të cilët i kanë udhëhequr doktorantët në vitin paraprak akademik	Numri i udhëheqësve, doktorantët e të cilëve i kanë mbrojtur punimet në vitin e mëparshëm akademik	Numri i punimeve shkencore të udhëheqësve, të publikuara në vitin paraprak akademik	Numri i punimeve shkencore të udhëheqësve, të publikuara në publikimet <u>ndërkombëtare</u> gjatë vitit të kaluar kalendarik	Numri i punimeve shkencore të udhëheqësve, të publikuara <u>në bashkëpunim</u> me doktorantët gjatë vitit të kaluar kalendarik				
<b>PËRPARIMI SHKENCOR I DOKTORANTËVE</b>								
<b>Drejtimi i përparimit</b>	Numri i doktorantëve të këtij studimi, të cilët kanë qenë jashtë vendit në qëndrim profesional	Kohëzgjatja (në ditë)	Numri doktorantëve nga jashtë, të cilët kanë qëndruar në studimet aktuale	Kohëzgjatja e qëndrimit të tyre (në ditë)				
Shkencor								
Angazhimi në procesin Mësimor								
Profesional/i zbatuar								
<b>VËREJTJE/KOMENTE (nëse ka):</b>								
Tiranë, _____					Nënshkrimi _____			
<i>(Përgjegjësi i programit të studimeve të doktoratës)</i>								



**SHTOJCA 15**  
**FORMATI I DEKLARIMIT ANTIPLAGJATURË TË KANDIDATIT**

Tiranë, më ...../...../202..

**Lënda: Deklarim për respektimin e rregullave të etikës së kërkimit dhe shmangjes së plagjaturës**

Unë i/e nënshkruari/a ....., ndjek programin e studimeve të ciklit të tretë Doktoratë në “.....”, në Fakultetin e ..... të Universitetit të Sporteve të Tiranës. Pasi jam njohur me rregullat e etikës së kërkimit, parashikimet për plagjaturën e pasojat përkatëse, nën përgjegjësinë time

**deklaroj se**

do të zbatoj me përpikmëri çdo kriter që lidhet me etikën e kërkimit shkencor, sikurse të parashikuar në Rregulloren e Organizimit të Doktoratës në UST dhe parashikimet specifike bashkëngjitur kësaj deklarate.

**Kandidati/ja Dr.**

**MSc.....**

## **Kritere specifike për shmangjen e plagjaturës në kërkimin dhe produktet shkencore**

*(bashkëngjitet Shtojcës 15)*

1. Kandidati nuk lejohet të paraqesë si punim, një punim që e ka paraqitur më parë në këtë njësi, por kandidati mund të paraqesë pjesë të punës nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.
2. Kandidati mund të paraqesë një pjesë kontributi që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një-grupi, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në punim.
3. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të tjerëve.
4. Përdorimi i ideve ose punës së tjerëve duhet të evidentohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.
5. Kandidati mund të përfshijë në disertacion edhe pjesë nga studime individuale apo të realizuara me bashkautorë, ose të dhëna të përfituara nga kërkime në kuadër të projekteve kërkimore të tjera. Nëse kërkimi është realizuar në ekip, kandidati e evidenton këtë fakt dhe njih kontributin e bashkëpunëtorëve.
6. Të gjitha citimet nga punimet e tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.
7. Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata se pesë radhë, nuk futen në thonjëza por shënohet referenca për to.
8. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore. Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të jepen të dy komentet burimi origjinal dhe burimi dytësor.